

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Për Programin e studimit Master Profesional “Marrëdhënie
Publike” me profile:**


- a) **Spektori Komerrial;**
- b) **Politik dhe institucionale**

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Arben Muka

Dr. Diana Kalaja



Qershor 2018



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Fakulteti/Departamenti që e ofron	Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit /Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr.74, datë 21.01.2009
4	VKA /Urdhëri i Akreditimit të parë	Vendim i KA Nr.133, datë 21.12.2010/Urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Me Urdhër Nr. 380, date 12.10.2015, MAS ka bërë ri-regjistrimin e formës së diplomës të lëshuar nga UET, me titull: Master profesional në "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale (*)
6	Cikli i studimit:	Cikli II
7	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (**)
8	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit (***)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Nga UET
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët/Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2009-2010
16	Numri total i studentëve për program studimi	
	2011-2012	a. Sektori Komercial 5 studentë b. Politik dhe institucionale 11 studentë
	2012-2013	a. Sektori Komercial 1 studentë b. Politik dhe institucionale 9 studentë
	2013-2014	a. Sektori Komercial 2 studentë b. Politik dhe institucionale 7 studentë
	2014-2015	a. Sektori Komercial 7 studentë b. Politik dhe institucionale 11 studentë
	2015-2016	a. Sektori Komercial 15 studentë b. Politik dhe institucionale 24 studentë
	2016-2017	a. Sektori Komercial 9 studentë b. Politik dhe institucionale 19 studentë
	2017-2018	a. Sektori Komercial 22 studentë b. Politik dhe institucionale 16 studentë

(*) Në VKA nr. 133/2010 titulli është: Master i Nivelit të Parë në "Marrëdhënie Publike" me profile: 1. Sektori komercial ose politik 2. Institucionale

Në Urdhërin Nr. 68/2011 titulli është: Master i Nivelit të Parë në "Marrëdhënie Publike", me dy profile

Me Urdhër Nr. 218, datë 23.05.2011, MAS ka bërë **regjistrimin** e formës së diplomës të lëshuar nga UET, me titull: **Master profesional në "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial ose Politik; b) institucionale**

(**) Nga 2010-2016 është ofruar me **60 kredite** dhe **90 kredite**

Nga 2016-në vazhdim është ofruar vetëm me **60 kredite**

(***) Nga 2010-2016 është ofruar me **1 vit** dhe **1.5 vite akademike**

Nga 2016-në vazhdim është ofruar vetëm me **1 vit akademik**

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale

Programi Master Profesional "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është licencuar me Vendimin VKM nr.74 datë 21.01.2009 dhe akredituar me Urdhërin Nr. 68 datë 14.02.2011.

Nga verifikimi i dokumenteve, ky program studimi është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 74, datë 21.01.2009. Emërtimi i programit, bazuar në dokumentin e licencimit (VKM Nr. 74, datë 21.01.2009) dhe urdhërit të regjistrimit të formës së diplomës (UMAS Nr. 380, datë 12.10.2015) është: Master Profesional në "Marrëdhënie Publike me profile: a. Sektori Komercial, b. Politik dhe Institucionale"

Programi licencohet si Master i Nivelit të Parë (MNP), 60 ECTS e me kohëzgjatje normale 1 vit. (VKM Nr. 74, datë 21.01.2009, Pika 3).

Në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, "për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". i ndryshuar, neni 99/3, pika 2 "Institucionet e Arsimit të Lartë të përshtasin brënda 6 muajve programet e studimeve, në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e këtij ligji", Institucioni deklaron se ka përshtatur programin e studimit me kërkesat e e këtij ligji, konkretisht:

1. Kohëzgjatja e programit nga 1 vit, u bë 1.5 vite akademike;
2. Për kurrikulën me 90 kredite, dy nga lëndët me zgjedhje në programin MP u bënë të detyrueshme. Pra studentët e programit me 90 kredite kanë frekuentuar dy lëndë më shumë krahasuar me studentët e të njejtit program me 60 kredite;
3. Sasia e krediteve (si dhe kohëzgjatja e praktikës profesionale) u rrit në 28 kredite

Për vitet 2010-2011 deri 2015-2016, programi është ofruar me 90 ECTS, e kohëzgjatje 1.5 vite (Master Profesional)

Aktualisht, nga 2016-2017, programi Master Profesional ofrohet me 60 ECTS, e kohëzgjatje 1 vit.

Akreditimi i parë është bërë me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit (VKA) Nr. 133, datë 21.12.2010 (Pozitiv, me rekomandime).

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit (UMAS) nr. 218, datë 23.05.2011 "Për Regjistrimin e formave të Diplomave "bachelor", "Master Profesional" [...] është bërë regjistrimi i Diplomave . Në këtë dokument emërtimi i diplomës është Master Profesional në **Marrëdhënie me Publikun** me profile:

- a) Sektori Komercial ose Politik;
- b) Institucionale

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit (UMAS) nr. 380, datë 12.10.2015 "Për Regjistrimin e formave të Diplomave "bachelor", "Master Profesional" [...] është bërë përsëri regjistrimi i Diplomave . Në këtë dokument emërtimi i diplomës është: Master Profesional në **Marrëdhënie me Publikun** me profile:

- a) Sektori Komercial;
- b) Politik dhe Institucionale

Akreditimi i parë i këtij program (60 kredite) është bërë me UMAS nr 68, datë 14.02.2011 "Për Akreditimin e programeve [...], Programet e studimit master i Nivelit të Parë [...]"

GRUPI I VLERËSIM TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Dr. Arben Muka
- Dr. Diana Kalaja

Gjatë zhvillimit të procedurës, GVJ, është asistuar nga Koordinatorët Teknikë të ASCAL, Renata Qatipi dhe Emisa Isufaj.

Më datë 13.06.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 15/26 Prot., datë 14.06.2018 me lëndë "Dërgohet Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm", UET është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 21.06.2018, UET përcjell nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL komentit: "Institucioni nuk ka komente apo sqarime shtesë lidhur me DRVJ të programit MP Marrëdhënie Publike". Ky koment është përcjellë zyrtarisht me shkresë nr. ___ Prot., datë __.06.2018.

Draft Raporti bëhet Raport përfundimtar i vlerësimit.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor;
- Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor;
- Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lendeve të kenë gradën shkencore "Doktor";
- Institucioni të punojë për punësimin më kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësim me kohë të plotë;
- Të aktivizohen më shumë ekspertë edhe në statusin "guest speaker" për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera, por edhe me ekonominë;
- Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve;
- Të bëhet i detyrueshëm disponimi i materialit (leksione të shkruara) në shqip
- Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion;
- Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh. programi MNP "Shkenca komunikimi", "MND Marrëdhënie Ndërkombëtare", etj.
- Kurikulat të përcaktojnë më qarët dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar;
- Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e kreditove për lëndë të veçanta);
- Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies gjatë javës;

- m) Të vazhdohet puna e nisur me universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht të shtohen kontaktet me universitetet e tjera;
- n) Të shikohet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin dhe përmirësimin e planeve mësimore;
- o) Të përmirësohet bashkëpunim me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për cikin e studimeve DND, MNP, e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit;
- p) Të rriten dhe forcohen kontaktet me punëdhënës brenda dhe jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentëve;
- q) Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase edhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze për studentët e diplomave DND, MNP, MND;
- r) Të shihet mundësia e uljes së tarifës së studimeve duke vendosur raporte më eficientë në shpenzimet p.sh. reklamata publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontingjenteve më cilësore;
- s) Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë;
- t) Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- u) Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor;
- v) Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurikulave.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “*Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor*”, institucioni ka vendosur edhe sistemin e granteve të kërkimore që lidhen me plotësimin e disa detyrimesh nga stafi. Për vlerësimin e punës kërkimore janë hartuar edhe **Indikatorët e Matjes së Performancës Kërkimore-Shkencore**. Këta indikatorë shërbejnë në dy drejtime, edhe për orientim për pedagogët në hartimin e punës së tyre kërkimore, ashtu edhe për rritjen profesionale të tij. Në UET janë krijuar edhe grupet kërkimore që udhëhiqen nga pedagogë me gradën Profesor dhe kanë anëtarë me fusha të ngjashme kërkimore.

Lidhur me kërkimin shkencor UET ka lidhur disa marrëveshje me universitete të huaja si edhe është pjesë e rrjeteve universitare. Rekomandim i plotësuar.
- b) Për rekomandimin “*Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor*”, UET ka formuar në bazë departamenti grup-lëndët. Përgjegjësi i grup-lëndëve shqyrton dhe firmos syllabuset, tezat e provimeve dhe tematikat e detyrave të kursit. Udhëheqësi i grup-lëndëve kujdeset edhe për respektimin e parimeve metodologjike të mësimdhënies më zbatim edhe të Strategjisë së kërkimit shkencor. Departamenti organizon edhe mbledhjet me stafin për planifikimin dhe ndjekjen e punës kërkimore të pedagogëve në përputhje me Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2017-2020. Rekomandim i plotësuar.
- c) Për rekomandimin “*Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore “Doktor”*”, Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike i ka të gjithë titullarët e lëndëve me gradën “Doktor”. Rritja e shkallës së kualifikimit në UET është një komponent i rëndësishëm që parashikohet edhe në Strategjinë aktuale të Kërkimit Shkencor. UET krijon mundësinë e pjesëmarrjes së pedagogëve

në konferenca shkencore si pjesë e projekteve të ndryshme universitare.
Rekomandim i plotësuar.

- d) Rekomandimin *“Institucioni të punojë për punësimin më kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësim me kohë të plotë”*

Ky aspekt i rekomanduar ishte në fokus të Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në takimet që zhvilloi me drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit ku përfshihet ky program Master Profesional, si dhe gjatë bisedës së zhvilluar me stafin akademik, apo gjatë verifikimeve që u bënë me personelin e Burimeve Njerëzore. U shqyrtuan disa praktika konkrete të procedurës së rekrutimit të stafit, të metodologjisë së plotësimit të dosjeve nga secili prej pedagogëve, të brendshëm ose të jashtëm. (Të dhënat konkrete të angazhimit të stafit akademik deri në momentin e vizitës në institucion janë paraqitur në tabelën përkatëse të paraqitur në aneks). Konstatuam se rregullimi me kontratë standard i angazhimit në UET nuk lejonte punësimin me kohë të plotë të njëkohshëm dhe në këtë universitet edhe në një institucion tjetër. Kurse angazhimi i personelit akademik të UET-it që kishte kontratë për punësim me kohë të plotë lejohej jashtë universitetit në formën e projekteve apo si konsulencë (me kohë të pjesshme), por kjo duhej të ishte e deklaruar si pikë më vete në kontratë. Nga biseda me pedagogët si dhe nga verifikimet në zyrën e Burimeve Njerëzore mësuam se për një anëtar stafi në UET, me kohë të plotë punësimi, deklarimi për angazhimet e tjera jashtë institucionit e realizohej ose në momentin kur nënshkruhej kontrata individuale, ose kur angazhimi fillonte pas nënshkrimit të kontratës. Në rastin e dytë veprohej me deklaram duke plotësuar formularin G.I.10.3, që përfshinte jo vetëm prezantimin e angazhimit jashtë institucionit, por dhe miratimin nga Administratori. Shprehim mendimin se ky rekomandim është plotësuar. Rekomandim i plotësuar.

- e) Për rekomandimin *“Të aktivizohen më shumë ekspertë edhe në statusin “guest speaker” për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera, por edhe me ekonominë”* institucioni ka krijuar edhe iniciativat “Forumet UET” ku janë të ftuar edhe ekspertë të ndryshëm. Pjesë nga këto forume janë të vendosur edhe në faqen online të UET. Në departament miratohen edhe lista e “guest speaker” që secili pedagog do të sjellë gjatë semestrit mësimor. Rekomandim i plotësuar.

- f) Për rekomandimin *“Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve”* Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike e ka plotësuar rekomandimin. Në këtë departament një titullar nuk jep më shumë se dy lëndë.

- g) Për rekomandimin *“Të bëhet i detyrueshëm disponimi i materialit (leksione të shkruara) në shqip”*. Sipas diskutimeve me drejtuesit e Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike dhe Fakultetit raporti i materialeve shqip /anglisht është 60% me 40%. Edhe sipas rregulloreve lejohet dhënia e materialeve në gjuhën angleze. Në departament vazhdon përkthimi i materialeve të domosdoshme, ndërkohë që studentët prezantimet i marrin në PowerPoint në gjuhën shqipe, si edhe materiale të tjera nëpërmjet sistemit intranet LMS. Pjesa e literaturës në gjuhën angleze lidhet me nevojën e pasjes së literaturës më të përditësuar dhe bashkëkohore e cila evoluon. Rekomandim i plotësuar kryesisht.

- h) Rekomandimi *“Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion”*. Për këtë rekomandim është e vështirë të aplikohet pasi lëndë të ndryshme me tematika të ndryshme e fakultete të ndryshme nuk mund të kenë normime të tilla. Ndaj dhe mendojmë se për këtë program studimi ky rekomandim është i paaplikueshëm.

- i) Rekomandimin *"Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh. programi MNP "Shkenca komunikimi", "MND Marrëdhënie Ndërkombëtare"*

Nga diskutimet që zhvilluam me stafin akademik, me drejtuesit e departamentit dhe dekanatit, por dhe me përfaqësuesit e zyrës së zhvillimit të kurrikulave dhe zyrën e koordinatorit të studimeve Master na u prezantuan ide dhe koncepte në favor të profilizimit të këtij programi Master Profesional, të mbështetur në misionin dhe objektivat e IAL-së, por dhe standardeve të njohura të kësaj fushe të edukimit, si dhe duke pasur parasysh vetë nevojat që ofron tregu konkret i punës. Procesi i profilizimit ka qenë hierarkik, me pikënisje nga departamenti e duke vijuar në rang fakulteti e deri në rang universiteti, por dhe ka qenë sistematik, duke reflektuar në mënyrë të vazhdueshme propozime dhe nisma për përmirësimin e kurrikulës së programit për dy profilet e programit, si ai Komercial ashtu dhe për atë Institucionale. Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.

- j) Rekomandimin *"Kurikulat të përcaktojnë më qartë dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar"*.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike në UET për Programin Master Profesional "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucional, i bazon syllabuset e lëndëve dhe literaturën në rregullat e brendshme për ndërtimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve. Nga diskutimet në Departament me pedagogë dhe studentë ata theksuan se megjithëse është një Master Profesional, baza teorike është e rëndësishme për të mos e shndërruar në një kur të thjeshtë praktik. Programi i detajuar në syllabuse ka 2-3 tekste bazë dhe literaturën e rekomanduar plotësuese. Mendojmë se ky rekomandim është i plotësuar.

- k) Rekomandimi *"Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta)"*

Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale mendojmë se ka ndërthurje të lëndëve teorike dhe atyre praktike me prezantime, pjesëmarrje aktive të studentëve, përdorimin e studios/laboratorit mediatik, dhe pra angazhim të studentëve. Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.

Për rekomandimin *"Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies gjatë javës"* institucioni e ka realizuar këtë orar bazuar edhe në komunikimet me studentët. Në programet e Master Profesional, pjesa më e madhe e studentëve është e punësuar dhe për rrjedhojë për ta është e përshtatshme mësimi në orët e pasdites së vonë dhe të shtunën. Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.

- l) Rekomandimi *"Të vazhdohet puna e nisur me universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht të shtohen kontaktet me universitetet e tjera"*

Ky është një rekomandim për institucionin në tërësi. Bazuar në informacionin që morëm nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, si dhe nga kontaktet me pjesëtarë të stafit akademik dhe mbështetës konstatuam rezultate nga procesi i mobilitetit të stafit akademik, në kuadër të zbatimit të projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Evropian; si dhe të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 po të Komisionit Evropian. UET-i bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë në Evropën Juglindore dhe BE, në kuadër të programeve Tempus, Jean Monnet etj., si dhe me programe mbështetëse për kërkimin nga donatorë ndërkombëtarë dhe lokalë si Regional Research Promotion Programme; NUFFIC, Assist Impact/USAID, Fondacioni Shoqëria e Hapur, American - Albanian Development Fund, Swiss Development Cooperation, Agjencitë e UN, etj. Ndërkohë që bashkëpunon me Universitetin e Aston-it në Britaninë e Madhe në kuadër të programeve të Shkollës

Doktorale dhe është pjesë e UNIMED - rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali); FEDE - rrjet evropian universitetesh me qëllim kërkimin shkencor (Portugali); është pjesë e SEUN - rrjet partnerësh mbi startup, sipërmarrjen rinore dhe inovacionin (Spanjë); UNIMED- Rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali) etj. Në vlerësimin tonë ky rekomandim është plotësuar në rang institucioni.

m) Për rekomandimin *“Të shikohet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin dhe përmirësimin e planeve mësimore”* institucioni ka ngritur grupe pune pas akreditimit të parë të cilët kanë pasur detyrë rishikimin e programeve mësimore. Në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike ka pasur rishikime të programeve, ndryshime të lëndëve dhe këto janë bërë për t'i shërbyer programeve më bashkëkohore mësimore. Ky rekomandim mendojmë se është plotësuar dhe nga Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike vijon periodikisht aktualizimi i planeve mësimore.

n) Për rekomandimin *“Të përmirësohet bashkëpunim me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për cikin e studimeve DND, MNP, e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit”* institucioni ka zhvilluar çdo vit, në kohën e aplikimit për universitet, fusha informuese me gjimnazet e ndryshme në të gjithë Shqipërinë. Në gjimnazet në qytetet kryesore grupe nga stafi i UET shkon dhe prezanton leksione të hapura dhe përparësitë që ofron UET për mësimdhënie dhe mundësinë e përfshirjes në projekte të ndryshme.

Nga takimet me studentët pjesëmarrës në Programin e studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale si formë marketingu ka shërbyer profili mediatik i UET dhe i pedagogëve të veçante të tij nga ky Departament. Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.

o) Për rekomandimin *“Të rriten dhe forcohen kontaktet me punëdhënës brenda dhe jashtë vendit për të ritur sigurinë e punësimit të studentëve”* institucioni ka krijuar edhe programin 250+ i cili i shërben pikërisht lidhjes së tregut të punës me fakultetet. Studentët na treguan se përmes sistemit të tyre LMS kanë në formate elektronike dhe në e-mail mundësi pjesëmarrje në trajnime të shumta dhe aplikime për projekte dhe mundësinë e krijimit të kontakteve me kompanitë që kërkojnë staff sipas profileve. Programi 250+, i iniciuar në 2016, është një program që krijon në bazë departamenti lidhje me kompani private apo institucione shtetërore ku studentët mund të bëjnë praktikat profesionale por edhe të krijojnë kontakte për punësime të mëvonshme. Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.

p) Rekomandimi *“Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase edhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze për studentët e diplomave DND, MNP, MND”*

Bazuar në dokumentacionin e sekretarisë mësimore, si dhe nga informacionin që morëm nga përfaqësues të stafit akademik të brendshëm, drejtuesit i departamentit dhe dekanatit, ishte evidente se për studentët e Programit të studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, që është në fokus të vlerësimit nuk rezultoi se kishte ndonjë kriter mesatareje për rekrutimin e studentëve, d.m.th. nuk kishte një kuotë kufi mesatareje. Drejtuesit e fakultetit ishin në proces shqyrtimi për ndonjë aplikim të mundshëm për këtë aspekt, por për momentin gjykonin se edhe pa këtë kriter sërish ka hapësirë që në procesin e përzgjedhjes së studentëve të ketë vëmendje për atë kontingjent të interesuarish që vijnë nga Bachelor-i, apo një nivel i ngjashëm me të, me mesatare mbi 7. Gjithsesi për nuk ka një standard të shkruar apo të vendosur e miratuar nga drejtuesit e UET, apo të fakultetit ku përfshihet programi. Për nivelin e përvetësimit të gjuhës së huaj, për Programin e studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale nuk aplikohet detyrimi. Stafi i pedagogëve dhe drejtuesit e fakultetit dhe departamentit u shprehën se pavarësisht kësaj, studentët aktualë kishin nivel të kënaqshëm të anglishtes dhe nuk ishte

- pengesë për aksesin e tyre në literaturën e detyruar a të rekomanduar. Në vlerësimin tonë ky rekomandim është plotësuar.
- q) Për rekomandimin *“Të shihet mundësia e uljes së tarifës së studimeve duke vendosur raporte më eficientë në shpenzimet p.sh. reklamat publicitare, për të rritur të tej interesimin e kontingjenteve më cilësore”* institucioni ka ndjekur politika mbështetje financiare për studentë nga grupe sociale të marxhinalizuara. Me bursa të plota ose të pjesshme mbështeten studentët e ekselencës, ata të familjeve në nevojë etj. Edhe nga takimi me studentët e Programit të studimit MP *“Marrëdhënie Publike”* me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, një pjesë e mirë e tyre e kishin marrë të reduktuar tarifën e shkollimit. Nga diskutimet me drejtues të universitetit po shikohet edhe mundësia e sistemi të ri tarifor. Në vlerësimin tonë ky rekomandim është kryesisht i plotësuar.
- r) Për rekomandimin *“Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë”* institucioni ka rritur nga viti në vit pjesëmarrjen në projekte të ndryshme. Mënyrat e angazhimit janë të ndryshme si në formate individuale të pedagogëve ashtu edhe nëpërmjet zyrës së projekteve përfshirja në rrjete universitetesh të huaja në Evropë. Rekomandim i plotësuar në rang universiteti.
- s) Rekomandimi *“Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit”*. Në shkallë universiteti ky rekomandim është i plotësuar me botime të disa monografive dhe kolanave të botimeve të ndryshme. Një tjetër mundësi botimi është edhe nëpërmjet dy revistave POLIS dhe ECONOMICUS. Shtëpia botuese UET Press është e pranishme më një numër të madh titujsh edhe në panairët e përvitshme të librit.
- t) Rekomandimi *“Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor”*
Megjithëse bëhet fjalë për një Program Master Profesional, që zgjat vetëm një vit akademik, sërish ka përpjekje për përfshirjen e studentëve në procesin e kërkimit shkencor, por që më e evidente bëhet gjatë procesit të ideimit dhe përgatitjes së punimit të diplomës, ndjekjes së seancave metodologjike si dhe konsultimet me udhëheqësin deri në finalizimin e punimit. Vlerësuar si Departament, pra përfshirë nivelin e studimit në Master Shkencor ka studentë që janë përfitues nga angazhimi në projekte mobiliteti në kuadër të Erasmus+, apo në programe dhe projekte ku UET-i është partner. Ky rekomandim është plotësuar.
- u) Për rekomandimin *“Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurikulave”* institucioni ka punuar si në rritjen e numrit të titujve fizikë që vijën në bibliotekë ashtu edhe me abonimet online të botimeve për studentet dhe pedagogët. UET është abonuar tek Questia një nga bibliotekat online me të vlerësuara për studentët. Ndërkohë nga vizita e GVJ në bibliotekë u vu re edhe pajisja me disa botime të institucioneve financiarë në vend që janë materiale që u vijnë në ndihmë studentëve për realizimin e detyrave të kursit dhe temave të diplomave. Ky rekomandim është kryesisht i plotësuar.

Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti Evropian i Tiranës është ndërtuar dhe e mbështet ecurinë e tij bazuar në kërkesat e ligjit për arsimin e lartë me synimin për tu dhënë studentëve edukim cilësor të ndërthurur me kërkimin shkencor në funksion të zhvillimit të vendit.

Masteri Profesional "Marrëdhënie Publike" me profile: (i) Sektori Komercial; (ii) Politik dhe Institucionale synon të edukojë specialistë të marrëdhënieve me publikun që do të shërbejnë për të përcjellë mesazhin nga kompania/institucioni/organizata tek audiencia e targetuar specifikisht duke promovuar produkte, apo hapësira komunikative. Programi synon t'i pajisë studentët me strategjitë dhe me teknikat komunikative dhe të shërbejnë edhe si ndërmjetës në raportin me audiencën respektive.

Universiteti ka një strategji të kërkimit dhe një strategji të zhvillimit të tij institucional të cilat ndërtojnë objektivat afatshkurtër dhe afatmesme të zhvillimit dhe vendosin pikësynimet se ku duan të arrijnë nëpërmjet programeve të studimit në secilin fakultet. Objektivat që departamenti synon përshtaten në varësi të kohës dhe ecurive të zhvillimit aktual edhe në tregun mësimor, duke e lidhur edhe me nevojat për profesionet në treg. Reflektim i saj bëhet nëpërmjet programit 250+ i cili realizohet nëpërmjet Bordeve të Tregut të Punës të ndërtuara pranë secilit departament të cilat lidhin kërkesën me ofertën për profesionistët në fushat respektive të kualifikimit.

Nëpërmjet faqeve online dhe sistemeve të brendshme të Teknologjisë së Informacionit stafi akademik, administrativ dhe studentët kanë mundësinë e transparencës mbi programet dhe projektet e UET si edhe dokumentacionin e përkatës të programit mësimor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programit i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale i studimit respekton rregulloret e brendshme të Universitetit Evropian të Tiranës dhe strategjitë zhvillimore të tij. Programi reflekton në brendinë e tij misionin e universitet për tu dhënë studentëve një edukim cilësor, duke përdorur edhe metoda kreative, literaturë bashkëkohore dhe arrijtjet më të mira të fushës studimore respektive. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në bazë të disiplinave përkatëse si: Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë; Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit; Kategoria C:
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblëdhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese; Kategoria D: Disiplina të zgjedhura; Kategoria E: Veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësi kompjuterike, praktika; Kategoria F: Përgatitja e tezës së diplomës. Ky ndërtim i programit është në përshtatje me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Përmbajtja e programit Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është në përputhje me synimin për ta pajisur studentin me: (i). Koncepte të aplikuara, të specializuara; (ii) Përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at; (iii) Formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative, laboratorëve; (iv) Aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; (v) Njohuri teorike bazë të fushës së studimit; (vi) Mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; (vii) Aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës. (viii) Diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi rasti, punë praktike ose produkt profesional;

Programi i studimit është në përshtatje me nevojat e tregut të punës. Krijimi i Bordit të Tregut të Punës dhe programit 250 + krijon një relacion të mirë të nevojave që ka tregu i punës me cilësitë dhe formimin që sigurohet në universitet. Krijimi i Bordeve të tregut të punës është përcaktuar që në statutin e UET Neni 18 "Organet Këshilluese" miratuar në shkurt 2017.

Sipas nenit 18.4 i Statutit të UET miratuar me vendim të Senatit Akademik 3/11/1016 dhe miratuar nga Ministria e Arsimit 27/02/2017

Programi i studimit reflekton rritjen dhe fuqizimin e zyrave të marrëdhënieve me publikun në thuajse të gjitha subjektet ekonomike/organizata/ parti politikë/institucione publike apo private. Ky program studimi reflekton edhe nivelin e zhvillimit aktual të medias në vend dhe kalimin nga mediat tradicionale në ato të reja dhe dixhitale.

Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale pasqyron vullnetin e institucionit që nëpërmjet koncepteve teorike, metodave kërkimore të ruaj dhe pasqyrojë edhe vlerat kulturore në vend.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të

Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me

institucionit;	profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është përshtatur me zhvillim në planin strategjik që ka institucioni. Në hartimin e kurikulave vit pas viti janë reflektuar eksperiencia që UET ka sjellë si nga tregjet e punës ashtu edhe nga ekspertiza mediatike që ofrohen. Ofrimi i studiuësve dhe zërave publike mediatikë në leksione dhe formate të ndryshme mësimdhënie përgjatë kurikulave përcaktohet edhe si një ndër drejtimet kryesore për zhvillimet strategjike të UET.
----------------	--

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Përmbajta e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Programi i studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është hartuar në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi dhe aktet nënligjorë të përcaktuar me udhëzime nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë. Ky program respekton ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe me “Procesin e Bolonjës”. Programi bazohet në Udhëzimin Nr. 4, datë 22.01.2008 “Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit Master të Nivelit të Parë dhe të Dytë”, në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 15, datë 04.04.2008 “Për Organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”.

Rregullorja e hartuar për këtë program studimi përcakton qartësisht si Strukturën e programit studimor ashtu edhe Kontrollin e dijës dhe vlerësimin

Emërtimi i Programit të studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur në përfundim të programit të studimit. Ky emërtim përshtatet edhe me përcaktimet e dhëna nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (niveli i studimit për diplomat Master). Ai përshtatet me kuadrin e tre cikleve të studimit të përcaktuara sipas rregulloreve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

UET ka hartuar dhe miratuar edhe Strategji për Kërkimin Shkencor.

Kërkimi shkencor ndërtohet në përputhje me misionin dhe vizionin UET dhe gjen pasqyrim në Strategjinë e Kërkimit Shkencor. Titullarët e fushave përkatëse në bashkëpunim me të gjithë departament prezantojnë pranë zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor programet e kërkimit shkencor.

Programi kërkimor i shërben edhe procesit mësimor

	<p>për ta ndërthurur atë edhe me pjesën teorike që marrin studentët. Për pjesën e programit MP "Marrëdhënie Publike", pedagogët dhe stafi akademik është i angazhuar në programe dhe kërkime praktike të lidhura me punën e tyre dhe subjektet respektive që ata japin në auditore.</p> <p>UET ka hartuar një strategji 5-vjecare të Mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve 2011-2015. Strategjia përshkruan metodat dhe teknikat bazë të mësimdhënies dhe të të nxënësit. Ato ndërthuren edhe me drejtimet e reja të zhvillimit të mësim dhënies. Kjo strategji duhet përditësuar pasi ajo është deri në vitin 2015 dhe për rrjedhojë nevojitet një rifreskim me zhvillimet e reja në drejtim të mësimdhënies dhe të të nxënësit, bazuar në zhvillimet e reja edhe në drejtim të kurikulës dhe përshtajës me kërkesat e tregut të punës.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Objektivat dhe misioni i Universitetit Evropian të Tiranës në përbërjeje të të cilit është edhe Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale plotëson standartet dhe janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UET, si dhe me kërkesat e tregut të punës për specialistë në këtë fushë. Programi është ndërtuar dhe përmirësohet vazhdimisht në përputhje me misionin e Institucionit dhe objektivat kryesore të tij. Objektivat e programit përcaktohen qartë dhe përfshijnë dijet teorike, aftësitë dhe kompetencat praktike profesionale në realizimin e punës së specialistit të marrëdhënieve me publikun.

Informacioni i nevojshëm për të ndryshuar dhe përsosur më tej programet mësimore merret nga disa forma si nga anketimet që bëhen me studentët, informacioni nga Bordet e tregut të punës, dhe vlerësimet e stafit akademik nga studentet online. Harmonizimi i informacionit të marrë si nga brenda UET edhe nga jashtë për nevojat kombëtare për zhvillim luan një rol të rëndësishëm në përditësimin e programeve akademike.

Sa më sipër ky Program i plotëson standartet për këto aspekte.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti Evropian i Tiranës ka në përbërje tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit. Secili fakultet ka në përbërje të tyre edhe Departamente të ndryshme të cilat pasqyrohet në Tabelat 1 dhe 2 në anekset në fund të raportit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Struktura akademike e **Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit, përbëhet nga :**

- Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
- Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
- Departamenti i Edukimit

- Programet e studimit që ofron Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe **Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit**

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit	
Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor) 1. Bsc. "Komunikim-Marrëdhnie Publike" 2. Bsc. "Komunikim Dizajn" Cikli i Dytë i Studimeve: 1. Msc "Komunikim - Marrëdhënie Publike" 2. MP "Marrëdhënie Publike" me profile: a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale Cikli i Tretë i Studimeve (Doktoraturë): 1. Dr. Shkenca Komunikimi

Struktura e departamentit nuk ka ndryshuar nga organizimi i saj themelor fillestar. Por në nivel Universiteti është forcuar sektori i kërkimit shkencor dhe zyra e Projekteve të Kërkimit dhe Zhvillimit duke sjellë mundësinë e përfshirjes së studentëve dhe stafeve akademike në programe kërkime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga analizimi i treguesve për ecurinë ndër vitet të stafit të Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike vihet re se ka ardhur në rritje numri i stafit akademik efektiv PAE që në vitin 2014-2015 ishte 10 pedagogë dhe në vitin 2017-2018 është 14 pedagogë si staf PAE. Ndërkohë që ka një tendencë në të lehtë në zbritje numri i stafit akademik me kontratë (PAK).

Përgjithësisht stafi akademik ka ruajtur një nivel qëndrueshmërie që prej vitit 2014. Grupi kryesorë i pedagogëve PAE që kanë qenë në vitin 2014 janë të gjithë edhe përsëri në departament, pra nga 10 në vitin 2014, në vitin 2017-2018 tetë prej tyre janë sërish në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike dhe në UET. Një qëndrueshmëri paraqet edhe grupi i personelit akademik me kontratë PAK por ja aq të larta sa pedagogët në PAE.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm është edhe niveli i titujve dhe gradave shkencore që i përkasin stafit akademik në Departament. Nga vetëm 3 grada që kishte stafi akademik efektiv në vitin 2014-2015, në vetëm 3 vite ky numër është rritur duke u katërfishuar në vitin 2017-2018. Në këtë vit 85% e personelit akademik kanë tituj "Doktor" dhe me grada më të larta. Ndërsa në total për personelin akademik efektiv dhe me kontratë (PAE dhe PAK) nga vetëm 29% e tyre kishin grada shkencore në vitin mësimor 2014-2015, në 72% e PAE dhe PAK kanë grada shkencore në vitin 2017-2018.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij; Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete; Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë.	UET është organizuar në përputhje me legjislacionin aktual. Gjithashtu UET, në përmbushje të misionit të tij ka tre Fakultete: Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti

Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;

Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;

Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".

Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit.

Secili nga tre fakultetet e listuara më sipër ka tre njësi përbërëse departamente dhe qendra kërkimore.

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit përbëhet nga tre departamente: (i) Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike; (ii) Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; (iii) Departamenti i Edukimit.

Secili nga Departamentet ka një mision të përcaktuar dhe rregulloret e tyre janë të miratuara. Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike ka një rregullore të saktë të mirë përcaktuar për funksionet e tij.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike në vitin mësimor 2017-2018 ka në përbërje të tij 14 anëtarë. Përgjegjësi i departamentit ka gradën Prof. Asoc. Dr. Po kështu ka edhe dy pedagogë të tjera me gradën Prof. Asoc. Dr. Ndërkohë një pedagogë me gradën PhD. Ndërkohë që ka disa me gradën "Doktor".

Ndër vite personeli akademik sidomos efektiv ka patur qëndrueshmëri. Bërthama e pedagogëve të efektivë të departamentit ka mbetur e gjitha në po këtë departament me pak përjashtime që kanë lëvizur në departamente të tjera të të njëtit fakultet në UET.

Ndërkohë që ka patur rritje të konsiderueshme nga vitit në vit të numrit të gradave shkencore për stafin akademik efektiv dhe atë me kontratë. Nëse është vetëm rreth 30 % e PAE me grada në vitin 2014-2015, në vitin 2017-2018 rreth 85% e PAE ishin me grada shkencore.

Përsa i takon nivelit të kualifikimit në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike raporti midis gadave shkencore midis PAE dhe PAK ka lëvizur në favor të PAE. Në se në vitin 2011-2012 kualifikimi i stafit akademik për tituj dhe grada midis PAE/PAK ishte 6:3 ky raport në vitin 2015-2016 ishte 10:2 dhe në vitin 2016-2017 ishte 9:4. Rritja e këtij raporti shpreh tendencën për të punësuar pedagogë efektivë që kanë tituj shkencorë duke sjellë kushtet edhe për mësimdhënie më cilësore në programet mësimore në Departament.

IAL ka edhe qendra kërkimi shkencor për të siguruar studentë të kualifikuar jo vetëm me programet teorike dhe praktike, por edhe për t'i patur ato sa më të përditësuar me të rejat dhe zhvillimet ndërkombëtare.

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike është njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimeve.

Përgjegjësia e departamentit është e përcaktuar në statutin e UET dhe rregulloren e brendshme të departamentit. Departamenti realizon çdo javë një mbledhje për të diskutuar mbi ecurinë e programeve mësimore dhe ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit mësimor. Departamenti si njësi bazë diskuton dhe miraton syllabuset mësimore, diskuton tekstet mësimore dhe literaturën që shoqëron lëndët, bën kërkimin për të gjetur librat më të fundit respektivë për lëndët dhe i diskuton ato për grup-lëndët nën drejtimin e përgjegjësve të tyre.

Bazuar në natyrën e programit mësimor dhe lëndëve të reja apo ndryshimeve që mund të bëhen në programin e secilit cikël studimi., drejtuesi i departamentit është propozuesi i personelit të ri akademik.

Drejtuuesi i departamenti në bashkëpunim me secilin pedagog shqyrton edhe raportet e vlerësimeve dhe anketimeve që bëhen me studentët për performancën e pedagogeve sipas lendeve mësimore.

Konkluzionet e vlerësimit.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" është ndërtuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme të UET.

Departamenti ka përgjegjësinë e realizimit të programit dhe cilësisë së tij, duke u kujdesur dhe marrë edhe vlerësimet e anketimeve të realizuara me studentët. Përgjegjësi i departamentit propozon edhe rekrutimin e personelit të ri në përputhje me nevojat që kanë programet e studimit.

Në konkluzion të vlerësimit të këtyre aspekteve shprehemi se standardi është plotësuar.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i rregullon marrëdhëniet e punës si në formatin e Kontratës me Kohë të Plotë dhe asaj me Kohë të Pjesëshme. Të gjitha format e kontratave detajohen në fillimin e procesit të lidhjes së saj dhe janë të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi, Kodit të Punës, statusin dhe rregulloret e UET. Nga vizita në zyrën e Burimeve Njerezore në UET u vërejt se të gjithë stafi akademik dhe mbështetës kishte dosjet me kontratat e tyre të përcaktuara.

Edhe pjesa e veprimtarisë kërkimore dhe shkencore është e detajuar në kontratë si pjesë e ngarkesës së punës.

Kriteret e rekrutimit të pedagogëve në Programin e Studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale përputhet edhe me kriteret e përgjithshme për rekrutimin e personelit në Ciklin e Dytë. Ndër kriteret kryesore janë ato të lidhura me titujt dhe cilësinë personale të kandidatit, Grada shkencore jo më pak se Doktor ose PhD; cilësia e universitetit ku kandidati është diplomuar, aktiviteti kërkimor dhe shkencor, përvoja e mëparshme në mësimdhënie, etj. Këto kriteret publikohen në faqen online në UET.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura didaktike (seksionet) për programin e studimit

Programi i Studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është nën organizimin e Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike dhe nga pikëpamja didaktike ka organizimin me grup lëndë me një përgjegjës të grup lëndëve i cili ka për detyrë të konsultojë përmbajtjen e lëndës në përputhje me objektivin formues të lëndës. Ai konsulton edhe literaturën e lëndës dhe firmos syllabuset e secilës lëndë, të cilat më pas firmosen nga përgjigjësi i Departamentit.

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat (Tabelat 3).

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe nga vizita në institucion numri i personelit akademik me tituj dhe grada përputhet me rregulloret e programit dhe të universitetit. Referencë - tabelat në anekset në fund të raportit. Tabelat 3

Në periudhën 2011-2012 Programi i Studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale kishte 6 pedagogë si staf akademik efektiv PAE dhe 3 si personle akademi me kontratë PAK. Por ndonëse raporti numerik ishte në favor të PAE, raporti i gradave shkencore ishte i ndryshëm, të gjithë PAK ishin me gradën "Doktor" ose më lart, ndërsa PAE vetëm 2 ishin me gradën "Doktor" dhe 4 të tjerë ishin ende në procese për marrjen e gradave shkencore.

Përgjithësisht ndër vite numri i personelit akademik efektiv PAE për Programin e Studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale ka qënë rreth 5-6 pedagogë që janë pjesëmrisht nga Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike dhe të plotësuar nga pedagogë nga Departamentet e tjera në UET.

Në vitin 2012-2013 raporti PAE/PAK për Programin e Studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale ishte 5:4, në vitin 2013-2014 ishte 6:4; në vitin 2014-2015 ishte 6:2; në vitin 2015-2016 ishte 10:2; në vitin 2016-2017 ishte 9:2 dhe në vitin 2017-2018 ishte 6:1. Pra sic shikohet ka ardhur duke u forcuar raporti në favor të PAE. Duke vëzhguar edhe emrat e PAK treguhet një qëndrueshmëri relative në pedagogët që japim mësim në këtë program.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Në Tabelat 3 gjendet të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet mes tyre. UET bën përpjekje për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik.

Lista e pedagogëve në Programin e Studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale tergon një rritje graduale nga viti në vit edhe të gradave shkencore. Ndër në vitet 2011-2012 pjesa më e madhe e PAK ishin në proces marrje të doktoraturës, me kalimin e viteve ata i kanë përfunduar dhe kanë marrë titullin "Doktor"

dhe drejtuesi i departamentit që është pedagoge në program ka marrë edhe titullin Prof. Assoc. Dr. Ndërkohë që nga PAE ka vetëm një pedagog në proces të marrjes së gradës “Doktor”. Edhe në raportet PAE/PAK për gradat dhe tituj akademikë raporti anon në favor të PAE.

Të dhënat sipas seksit

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun është i balancuar nga kriteri i gjinisë me predominancë të pedagoqeve femra. Kjo tendencë vërehet edhe në pedagogët e Programit të Studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat 5)

Pedagogët në Programin e Studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale luhaten në grupmoshat 25-35 vjec 4 pedagogë dhe 35 – 45 vjec 2 pedagogë. Kjo ka krijuar një ndërthyrje të brezave në mësimdhënie duke krijuar mundësinë e përfshirje së përvojave të ndryshme në mësimdhënie. Moshat e ndryshme, kryesisht të reja sjellin të pasqyruar edhe përvojat individuale zhvillimet e reja dhe ndërthyrjet e teknologjisë që ka pësuar industria mediatike të cilat duhet të pasqyrohen edhe në programin didaktik.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit Referenca lidhur me Këshillin Shkencor të programit dhe emrat e tyre gjenden në Tabelën nr.4 në anekset në fund të raportit.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Zyra e Burimeve Njerëzore ka kontratat individuale të secilit nga anëtarët e stafit. Kontratat janë të formosura dhe stafi është i njohur me detyrat dhe të drejtat e tyre sipas kontratave respektive. Me zgjedhje, GVJ shikoi disa kontrata të personelit akademik dhe mbështetës në Departamentin e Marrëdhënieve Publike të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli akademik për Programin e Studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik është pjesë e Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike, si pjesë e strukturës organizative të UET dhe kryesn procesin e mësimdhënies së bashku me veprimtaritë e lidhura me të. Stafi ndihmës dhe personeli administrativ Që ndihmon për këtë program studimi nuk është më vete i dedikuar por i përbashkët edhe me programet e tjera të studimit të këtij departamenti, Departamenti ka një sekretare e cila i shërben të gjitha programeve që ka departamenti. Personeli administrativ dhe mbështetës, sekretaria mësimore është e përqëndruar në zyrat e sekretarisë mësimore, por personeli është i dedikuar për fakultetin dhe departamentin dhe nuk ka personel administrativ specifik për këtë program studimi. Nga vizita dhe takimi në sekretarinë e UET vërehej rregullsi e qartësi në plotësimin e dokumentacionit, rregjistrave themeltarë dhe matrikullimeve për studentët e programit. Sistemi kishte disa rregjistra që plotësoheshin nga sekretaria edhe në rastet e notave, pjesëmarrjeve dhe vlerësimet që ishin në përputhje me rregulloret e ardhura nga MAS. Nga verifikimet në sekretari rregjistrat korespondonin midis tyre informacion dhe ishin të harmonizuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Objektivat e programeve të studimit dhe ecuria në arritjen e tyre u bëhen të ditur stafit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ që në fillim të programeve të studimit dhe në vazhdimësi ato janë të postuara në faqen online dhe sistemin e brendshëm të komunikimit UMIS dhe LMS (Learning Management System). Në këto sisteme jepen edhe drejtimet e reja në përputhje me strategjinë për zhvillim që ka UET.</p> <p>Në rang universiteti, funksionon edhe Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si një njësi me vete, e cila bazuar në rregulloren e universitetit vlerëson periodikisht punën mësimore dhe kërkimore dhe jep edhe rekomandime në rastet kur veprimtaria duhet të përshtatet më tej si me objektivat e programeve të studimit ashtu edhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Hartimi i kurikulave është detyrë e njësisë bazë të çdo fakultetit dhe në rastin e Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është detyrë e departamentit përkatës. Çdo pedagog i këtij departamenti në mbledhjen javore, por edhe në takime të tjera mund të propozojë ndryshime, plotësime të kurikulës duke dhënë edhe argumentin përkatës. Propozimet për kurikulat kalojnë në disa shkallë miratimi, nga departamenti drejt Këshillit të Fakultetit dhe më tej Senatit Akademik.</p> <p>Përcaktimi i ngarkesës mësimore si edhe rekrutimi i pedagoqeve të rinj bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu për këtë merren në konsideratë edhe objektivat e departamentit dhe programit të studimit specifik. Këto objektiva përshtaten edhe zhvillimet me të reja në fushën përkatëse të programit të studimit.</p> <p>Në kete program plotësohet kriteri i dhënies mësim me grada dhe tituj shkencor.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës, ndjek procedura dhe aktet ligjore në rekrutimin e personelit në përputhje me statutin. Procesi përzgjedhës për rekrutimin e personeli përfshin aplikimin</p>

të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

individual për pozicionet e njoftuara dhe konkursin përzgjedhës.

Pedagoget që japin mësim në Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale janë të punësuar dhe me kontratë si personel efektiv në UET (PAE) Vetëm një nga pedagogët është i punësuar me kohë të pjesshme në këtë departament. Secila nga lëndët në varësi të kurikulës mund të ftojë "guest speaker" në realizimin e syllabusit.

Raportet midis Personelit Akademik Efektiv ndaj totali të personelit akademik të angazhuar në Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale është si më poshte:

Viti akademik 2017-2018 është 6/7 pra 85.7%

Viti akademik 2016-2017 është 9:11 pra 81.8%

Viti akademik 2015-2016 është 11:13 pra 84.6%

Viti akademik 2014-2015 është 6:8 pra 75%

Viti akademik 2013-2014 është 6:10 pra 60%

Viti akademik 2012-2013 është 5:9 pra 55.5%

Viti akademik 2011-2012 është 6:9 pra 66.6%

Pra sic shikohet këto raporte kanë ardhur në rritje dhe pas vitit 2014 ato kalojnë shifrën e 75% duke treguar se mbi 75% e personelit në jep mësim në Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale është personel akademik efektiv PAE.

Pra sic shikohet këto raporte kanë ardhur në rritje dhe pas vitit 2014 ato kalojnë shifrën e 75% duke treguar se mbi 75% e personelit në jep mësim në Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale është personel akademik efektiv PAE.

Ndërsa Raportet midis Personelit Akademik Efektiv ndaj totali të personelit akademik të angazhuar në Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale e llogaritur në ngarkesë mësimore për tre vitet e fundit është si më poshtë:

Viti akademik 2015-2016 është 51 kredite/9 kredite pra 85.0 %

Viti akademik 2016-2017 është është 54 kredite/6 kredite pra 90.0 %

Viti akademik 2017-2018 është është 51 kredite/9

	<p>kredite pra 85.0 %</p> <p>Vlerësimi i pedagogeve kryhet në disa nivele: nga drejtuesi i drejtpërdrejtë në këtë rast ai i Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun; dy herë gjatë vitit akademik nga studentët nëpërmjet fokus grupeve dhe anketimit online; si edhe vlerësimi institucional nga drejtuesit që është në vazhdimësi.</p> <p>Në dosjet e secilit pedagog (pranë zyrës së burimeve njerëzore) ndodhen edhe vlerësimet që bëhen atje nga studentët gjatë vitit akademik.</p> <p>UET ka zyrën e Burimeve Njerëzore dhe atë të arkivës që mban bazën e të dhënave të raporteve të vlerësimit, rekrutimit të personelit, intervistat e kandidatëve, njoftimeve për vende vakante, etj.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun që ku përfshihet dhe Programi i studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale ka titullin “Profesor Assoc. Dr.” si edhe përvojë akademike;</p> <p>Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programin MP “Marrëdhënie Publike” kanë grada dhe tituj (Prof. Assoc. Dr - 2 pedagogë, gradën shkencore “Doktor” - 3 pedagogë, dhe një asistent lektor është në përfundim të shkollës doktorale.</p> <p>Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në UET</p> <p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në Programin e studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale.</p>
---	---

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën</p>	<p>Secili nga studentët që ndjekin Programin e studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale kanë një udhëheqës për tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve. Udhëheqësit e tezës janë të paktën gradën</p>
---	--

<p>shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>shkencore "Doktor". Udhëheqësi zhvillon me studentët seancat metodologjike për udhëheqjen dhe realizimin e punimit, Zakonisht ditën e premte 15:00 – 17:00 në UET nuk ka mësim por zhvillohen këto seanca metodologjike. Udhëheqësi bën edhe takime të personalizuara me studentët.</p> <p>Sipas vlerësimeve dhe ngarkesës së lëndëve si edhe informacionit në departament një pedagog udhëheqës ka numër studentësh në përputhje me standardet e vendosura.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun kujdeset për përshtatjen e fushës studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi me atë në të cilën ofrohet teza studimore. Në plotësimin e kërkesave të studentëve hartohet një matricë për pedagogët dhe fushat e tyre të kualifikimit krahas edhe tematikeve të përzgjedhura nga studentët.</p> <p>Në rastet kur nuk mund të plotësohet kjo me pedagogë të fakultetit, apo kur temat janë të ndërthurura me tema të tjera, shikohet mundësia e udhëheqësve nga jashtë si pedagogë të jashtëm, brenda kriteve të lejuara.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës, ndan së bashku me departamentet e tjera dhe fakultetet e UET personelin ndihmës mësimor –shkencor të tillë si zyrën e TI, bibliotekën, sekretaritë kryesore, zyrën e kërkimit shkencor dhe zyrën e karrierës dhe praktikave.</p> <p>I gjithë personeli i këtyre zyrave ndihmon studentët e programit për të realizuar detyruar e tyre, për të siguruar zhvillimin e rregullt të praktikave mësimore, marrjen e informacionit të nevojshëm dhe komunikimin efektiv në shërbim të procesit mësimor.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Në përputhje me kontratat e lidhura me UET, stafi akademik i Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun realizon ngarkesën mësimore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. UET ka hartuar një sistem me koeficiente për konvertimin e orëve të ndryshme të pedagogeve në orë njësi për efekte të llogaritjes së ngarkesës së</p>

dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	punës. Ora e mësimdhënies direkt në auditor është e barabartë me 1.25 orë njësi. Me koeficiente konvertohen në orë njësi edhe udhëheqja e studentëve, praktikat mësimore etj.
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës ka të evidentuar ngarkesën mësimore, profilin dhe fushat e tyre kryesore të ekspertizës, eksperiencat e veçanta dhe profilet akademike. Gjithashtu edhe zyra e Burimeve Njerëzore në UET ka dosje të veçanta për çdo pedagog të UET duke krijuar një bazë të rëndësishme të dhënash. Në këtë zyrë mbahen edhe kontratat e lidhura me stafin vit pas vit (në rastet e ndryshimeve dhe kontratave me afat). Në faqen në Internet dhe në median e sistemit pranë UET publikohen kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Bazuar në RVB, në konstatimet gjatë vizitave dhe diskutimeve me stafin akademik dhe studentët, vlerësojmë se standardet plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme të UET.</p> <p>Stafi akademik efektiv mbulon mbi 70 % ngarkesën mësimore</p> <p>Komunikimi nëpërmjet sistemit të brendshëm online intranet, LMS, është një mekanizëm mjaft i mirë për të shpërndarë informacionin dhe për ta bërë atë sa më transparent. Personeli administrativ është mbështetës i atij akademik dhe mjaft i mirë i informuar për objektivat dhe synimet e programeve mësimore të UET.</p> <p>Ndaj dhe shprehemi se standardi plotësohet.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Tre godinat funksionale, Godina A me 4 kate, (çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m²), Godina B, (po me 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m²), Godina C (ambjentet e Bibliotekës me sipërfaqe 300 m²)- përbëjnë kompleksin universitar të UET, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H1, Tiranë.

Duke iu referuar bazës dokumentare, i gjithë aktiviteti zhvillohet në një sipërfaqe të katër ndërtesave, që shkon në rreth 10,000 m². Në hapësirat mes ndërtesave ka një vendparkim për rreth 120 automjete që përdoren nga trupa pedagogjike, studentët, ose nga personeli mbështetës, ndërkohë që në pjesën e përparme të kompleksit universitar ndodhet një lulishte me stola të jashtëm.

Objekti është i pajisur dhe me shkallë alternative për rastet emergjente të daljes, gjithashtu godinat kanë pajisje dhe mjete bazike për të vepruar kundë zjarrit: një fikse zjarri në çdo kat, dhe nga një fikse zjarri në burime potenciale zjarri, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatësisht rrufe-pritëse. Kompleksi universitar ka dy linja furnizimi me energji elektrike, linja kryesore nga e cila furnizohet zona, si dhe një linjë alternative me motogeneratorë, për rastet e ndërprerjeve dhe avarive. Po kështu është garantuar dhe furnizimi me ujë, ku krahas rrjetit publik, ka dhe burim alternativ përmes pusit dhe pompave, për të mbajtur në çdo rast rezerva për përdorim. Për ngrohjen dhe freskimin e ambienteve të brendshme ka një sistem qendror, i cili bazuar në dokumentacionin e institucionit është i çertifikuar dhe mirëmbahet rregullisht.

Ambientet brenda kompleksit universitar ishin me shërbim Wi-Fi, që krijon lehtësi për akses në internet. Këtë e konstatoam gjatë vizitës në mjediset e UET-it, ku evidentuam dhe se auditorët kishin pajisje audio vizive të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, me projektor dhe sistem dëgjimi. Kurse në laboratorët e informatikës/statistikës ishin instaluar softwarët përkatës, në shërbim të zhvillimit të programit mësimor: windows 7, paketa Microsoft Office 2016 me të gjithë softwarët e saj (Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace dhe word).

Universiteti ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) dhe 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare), të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.

Ndërsa për programet e Informatikës së avancuar, statistikës dhe programit Master në informatikë ekonomike janë instaluar programet: Navicat for my SQL; NetBeans; Apache Tom Cat; SPSS 19. Laboratorët kanë mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit.

Për informimin sistematik të studentëve ishte sistemi MOODLE (UET LMS), një deponitë virtuale e cila në kohë reale aktualizohet me përmbajtje dhe njoftime që hidhen nga pedagogët, si leksione, materiale shtesë audio vizive, etj. Përmes këtij sistemi studenti ka mundësi të komunikojë në forume të hapura me pedagogët, drejtuesit e departamentit, si dhe kolegët e kursit që ndjek; të informohet për rezultatet.

Biblioteka

Nga vizita në Bibliotekën e UET-it u informuam se shtimi me tituj të rinj të fondit bëhet përmes:

- blerjeve në fillim të çdo fillim viti akademik të teksteve universitare dhe librave të reja, që që janë pjesë e literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar;
- blerjeve në Panairin e Librit që hapet në Tiranë, çdo nëntor, të atyre botimeve që lidhen me kurrikulat e procesin mësimor në fakultetet e UET-it;
- nga përkthimi e botimi nga UET Press-it i teksteve (përfshirë tekste universitare dhe monografi shkencore, të cilat kanë si autorë pedagogë të UET-it, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë. Këtu bëjnë pjesë edhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që janë botuar dhe botohen nga universiteti.
- nga porositë dhe blerjet online në Amazon.com e shumë botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në fusha të ndryshme të shkencës. Punonjësit në Bibliotekë treguan gjatë vizitës aty tituj të abonimeve në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik kërkesat që ata kanë. Disa nga revistat shkencore të huaja janë Harvard Business Review; The

Economist; Foreign Affairs; Commentaire; The Nations Interest; Educational Leadership etj.

- nga dhurimi që bëjnë organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja, individë dhe fondacione. Biblioteka ka dhe një hapësirë të botimeve të vetë UET-it, tituj akademikë (kryesisht tekste bazë dhe monografi) të botuara nga UET-Press, të cilat kanë autorë shqiptarë ose janë përkthime të disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit të botuara në shqip nga UET Press.

Stafi i Bibliotekës orienton studentët, stafin pedagogjik apo punonjësit e UET për të gjetur literaturën që u nevojitet. Salla ishte e ardhur në mënyrë që për secilin përdorues të kishte kushte të përshtatshme leximi a konsultimi me fondin që shfrytëzon. Studentët që ndjekin programin e Masterit Profesional që është në fokus të vlerësimit gjatë pranuar se kanë shumë lehtësi nga shërbimi në mjediset e bibliotekës, ku gjejnë publikimet që ju duhen për procesin mësimor.

Por inventari i librave dhe periodikut është duke u reduktuar, pasi humbin kopje, nga ata përdorues që nuk e kthejnë sërish inventarin e huazuar tek punonjësit e shërbimit. Kjo favorizohet nga mungesa e sistemeve të monitorimit dhe sinjalizimit në hyrje - dalje apo brenda mjediseve të sallës e favorizon këtë fenomen.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Bazuar në dokumentacionin e institucionit (RVB), raportin brendshëm të vlerësimit, si dhe nga verifikimi që u bë për mjaft nga treguesit gjatë vizitës dyditore, rezultoi se:

Mjediset akademike

- Sipërfaqja e brendshme është e ndarë në salla leksionesh, (10 salla me sipërfaqe totale 1510 m² dhe 1515 vende).
- Salla seminari janë 14, me sipërfaqe 45 m² dhe secila me nga 35 karrige.
- Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100 m² secila.
- Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45 m² secila.
- Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 8 ambiente me nga 18 m².
- Zyra për koordinatore janë gjithsej 6 ambiente me nga 14 m².
- Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45 m² secila me kapacitet 35 vende.
- Sallë interneti me sipërfaqe 165 m² me 80 kompjuter.
- Zyra për pedagogët janë 30 me sipërfaqe 14 m² secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe 150 m², me 32 poste pune.
- Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300 m², 150 vende leximi.
- Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150 m².
- Zyra informacioni për studentët janë 2.
- Korridore plus holle janë gjithsej 8 me 150 m² secili.
- Mjedisi çlodhës për kafe/fastfood/etj. është në një sipërfaqe të vetme 500 m².
- Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300 m².

Mjediset për stafin:

- Zyra për dekanin/ zv.dekanin/kancelarin janë 5 me nga 20 m².

- Zyra për sekretarinë mësimore janë 3 me sipërfaqe 140 m².
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ janë 12 me sipërfaqe 350 m².
- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore janë 3 me sipërfaqe 140 m².

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Kompleksi universitar i UET, (adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë), ka tre godina funksionale (Godina A me 4 kate, çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m²; Godina B me 4 kate, çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m²; Godina C, ku ndodhet biblioteka e Universitetit me sipërfaqe 300m². Sipërfaqja e përgjithshme e godinave është rreth 10,000m².</p> <p>Në këtë vendndodhje UET-i ka prej shtatorit 2007 dhe infrastruktura e institucionit është përmirësuar vazhdimisht duke ofruar hapësira të nevojshme dhe komode.</p> <p>Gjithashtu për një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, mësimi në ciklin e parë të studimeve, Bachelor, zhvillohet nga e hëna në të premte, 9:00-16:00, ndërsa në programet e ciklit të dytë, Master ditëve të javës nga ora 17:00 deri në orën 20.00. Të shtunave orari është 9:00 – 16:00. Studentët e Programit të studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale e kishin orarin e ndjekjes së procesit mësimor nga ora 17.00 deri në 20.00. Studentët e këtij Programi u shprehën gjatë takimit që zhvilluam se mjediset ku zhvillonin procesin mësimor, ishin të bollshme dhe funksionale.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë</p>	<p>Në fondin e bibliotekës së UET-it përfshihen në total 6005 tituj të disponueshëm për studentët dhe personelin akademik dhe ndihmës, prej të cilave në gjuhën shqipe janë 4634 tituj, kurse në gjuhë të huaj 1371 tituj.</p> <p>Për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit, ku bën pjesë dhe Programi Master Profesional që vlerësohet, në bibliotekë ka mbi 3700 tituj (në gjuhët anglisht, frengjisht, italisht e gjermanisht).</p> <p>Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për</p>

hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

t'i shërbyer pedagogëve dhe studentëve. Nga biseda që zhvilluam me punonjëset e bibliotekës, si dhe nga dokumentacioni që na u prezantua evidentuam furnizimin e vazhdimshëm me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve online të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Botimet periodike në total janë 162, nga këto 102 janë në shqip dhe 60 janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht). Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage.

Orari i Bibliotekës është: nga e hëna në të premte 9:00-20:00, kurse ditën e shtunë orari është 9:00:17:00. (gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur). Orari favorizon dhe studentët e këtij Programi, gjë që u pranua nga ata si lehtësi meqënëse procesi mësimor zhvillohet pasdite.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Universiteti ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) dhe 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare), të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.

Gjatë vizitës në mjediset e korpusit universitar u evidentuan se sallat në të cilat zhvillohen si leksionet ashtu edhe seminarat janë të pajisura me PC dhe videoprojektor, të cilat i vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik.

Mbulimi me sinjal Wi-Fi ishte lehtësi për studentët dhe stafin akademik e mbështetës që të aksesohen në hapësirën virtuale. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e informatikë/statistikës janë pajisur me softëare-t e nevojshëm për zhvillimin e praktikave profesionale. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjete didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore.

Sa i takon praktikave profesionale, UET ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për

të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Librari, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave, Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatoreve të Departamenteve.

Konkluzionet e vlerësimit:

Standardet e këtij institucioni të arsimit të lartë, ku përfshihet dhe Programi i studimit Master Profesional "Marrëdhënie Publike" me profilet Sektori komercial dhe Politike dhe institucionale, për mjediset, infrastrukturën, teknologjitë e informacionit, bibliotekën, shërbimet e tjera për studentët, dhe rezidenat janë plotësuar. Studentët dhe stafi akademik në këtë Program studimi e zhvillojnë procesin mësimor në një infrastrukturë funksionale.

UET-i ofron në tre godinat sistem kondicionimi dhe ëireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Sallat mësimore janë të pajisura me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra dyshe. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë dhe sallat e mbledhjeve.

Biblioteka ka një fond librash dhe periodikësh që është vazhdimisht në përpjekje për t'u pasuruar, si në gjuhën shqip ashtu dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore.

Vlerësojmë se standardet plotësohen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një aspekt jetik për funksionimin e universitetit, mbi të gjitha për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimor e shkencor në fakultetet dhe në mënyrë kapilare në njësitë e tjera përbërëse të tyre. Si burim kryesor financimi janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit, ndërsa një kontribut tjetër lidhet me aktivitetet tregtare (qeradhënie, parkim etj.) Bazuar dhe vlerësimin e brendshëm, specifike për vitet e fundit, 2013-2016 është edhe kontributi i granteve për kërkim dhe kontratat.

Universiteti Europian i Tiranës kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpk përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor jep opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më 31 dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Dokumentacioni përkatës vërtetues janë bilancet vjetore dhe raportet e auditorit të pavarur

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje), marrë nga RVB):

- Grantet për kërkim 1-2%
- Konsulencat, shërbimet 0%
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit 83-85 %
- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 13-16%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
 Projekti financiar hartohet në muajin korrik të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij projekti, ngarkohet Zv.Administratori dhe Zyra e Financës.

Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajis me "Kërkesë për Lëvrim fondesh", e miratuar nga Zv.Administratori. Konsumimi i cash-it bëhet vetëm me fatura të rregullta tatimore, lëvizjet bëhen me bankë. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë që gjithmonë të ketë një rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, në mënyrë të tillë që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>UET ka raport auditit çdo vit.</p> <p>Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e prezantuar në secilin vit akademik UET harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare behet sipas akteve te brendshme te institucionit.

UET respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sa me siper shprehemi se standardet plotesohen.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

UET tregon vëmendje për të mbajtur në mënyrë dinamike sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, si një instrument që garanton një veprimtari institucionale në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht duke u shfaqur në formatin e grupeve ad hoc, dhe që nga fillimi i vitit 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit (Tabela nr. 6 në Aneks). Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm shikohet si e dobishme në favor të sigurimit me më shumë objektivitete dhe paanshmëri në gjykimet dhe rezultatet e vlerësimit, si edhe për të marrë feedback nga ekspertë, të cilët mund të sjellin perspektiva e këndvështrime të ndryshme, për të përmirësuar më tej praktikën e zbatuar.

Ngritja e organeve këshilluese si Bordi i Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe Erasmus+: QAINAL). Angazhimi në këto projekte dhe trajnimet, siç ishte pjesëmarrja e 3 autoriteteve drejtuese të institucionit në aktivitetin "International Quality Assurance Programme" të organizuar nga Agjencia Britanike QAA, i shërbejnë përditësimit me praktikën e mira të sigurimit të cilësisë.

Formë tjetër për të siguruar cilësinë është dhe kontrolli i provimeve të ndërmjeteme dhe atyre të semestrit. Katër herë në vit KSBC kryen këtë proces, rezultatet e të cilit pasqyrohen në raportet përkatëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET është Pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Kjo çështje ishte objekt diskutimi gjatë takimit që ekspertët e vlerësimit të jashtëm zhvilluan me studentët si dhe me stafin akademik e drejtuesit e departamentit dhe të Fakultetit ku përfshihet Programi Master Profesional në shqyrtim. U evidentua se skedat e pyetësorëve janë të hartuara me pyetje të qarta dhe të drejtpërdrejta, dhe për atë që e plotëson online ruhet anonimat. Të dhënat përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Për drejtuesit e departamentit si dhe ata të fakultetit të dhënat e përfutuara janë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit. Ndër problemet më kryesore kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimit, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. U konstatua se megjithë vëmendjen e madhe që i kushtohet pyetësorëve, si dhe aspektit që përgjigjedhënsi mbetet anonim, nuk ka ndonjë interes nga studentët për t'u përfshirë në këtë proces. Për studentët e Programit Master Profesional "Marrdhënie Publike" pjesëmarrja në përgjigjen e pyetësorëve është në rreth 20%.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSBC, e zhvillon aktivitetin e vet sipas një plani kalendar (që njihet dhe si Plani i veprimit) në mënyrë të përvitshme, plan që ka të programuar sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. KSBC periodikisht informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësitve të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimit, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Ky aspekt i fundit u përmend dhe gjatë takimit me pedagogët, të cilët e vlerësuan pozitivisht.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

KSBC ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit, dhe vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET-it. Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohet përmes paraqitjes në Intranet të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, etj, legjislacionin përkatës, urdhërat e Rektoratit të UET-it etj. Në këtë kuadër, për secilin program lëndë që është pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas gruplëndëve dhe në departament.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga "fokus grupet" si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të folloë up-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion eëb për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Grupi i vlerësimit të jashtëm monitoroi një rast konkret aksesi për në LMS dhe evidentoi se sistemi ofron informacion të personalizuar, merr vetëm informacionin dhe të dhënat e atij që e përdor. Gjatë takimit me studentët e Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale u vlerësua maksimalisht ky sistem komunikimi virtual, si një lehtësi për ta që në kohë reale të shikojnë njoftime, kanë mundësi të shkëmbejnë materiale nga procesi mësimor, mbi detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj., mund të drejtojnë pyetje për pedagogun etj.

LMS ndihmon në rritjen e cilësisë së procesit të ndjekjes së studimeve, pasi për secilin përdorues garantohet marrja e bazës didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme. Njëkohësisht, ky sistem ofron mundësi për KSBC-në, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet 	<p>KSBC si struktura përgjegjëse për menaxhimin vlerësimit për ecurinë e programeve të studimit në UET, realizon kontrole gjatë vitit akademik dhe gjetjet i bën prezente pranë drejtuesve të Rektoratit, si dhe atyre në fakultete.</p> <p>Vlerësimi i veprimtarisë akademike dhe administrative realizohet përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Të dhënat përpunohen sistematikisht nga ana e sektorit të statistikave (mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj.)</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta: Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista;</p> <p>Të drejtpërdrejta: Teste të standardizuara; Dëgjime në auditor; Vlerësimi me pikë;</p>

<p>e vlerësuar me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës.</p>
--	---

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.</p> <p>Nga ana tjetër nuk rezultoi se janë publikuar virtualisht në faqen online të institucionit ndonjë Prezantim (raport) mbi treguesit e cilësisë së brendshme qoftë për të gjithë institucionin, apo qoftë për njësi të veçanta të tij.</p>
---	--

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.</p> <p>Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në "fokus grupe" dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p>
--	---

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Në plotësim të standardeve institucionale UET-i është akredituar dhe riakredituar, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Programet e studimit për të cilat ka nisur procesi i akreditimit periodik, janë akredituar nga institucionet përgjegjëse. Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe KSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të antarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.

Për të siguruar cilësinë e proceseve akademike UET harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.

Një rol të veçantë luajnë mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, ndër të cilët përmendim atë për format e kontrollit; organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar në UET, sistemin LMS, etj.

Ndërgjegjësimi i personelit synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.

Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të KSBC dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikura në intranetin e UET.

Konkluzionet e vlerësimit:

UET i plotëson standardet e institucionalizimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritjen e Njësisë së SBC, funksionimin e saj, vetëvlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.

Një nga instrumentet për vlerësimin e cilësisë në UET, ku përfshihet dhe Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është Pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Për të evituar keqkuptime në tërheqjen e mendimit të studentëve procesi zhvillohet para sezonit të provimeve dhe përgjigjet që jepen virtualisht ruajnë anonimat. Pyetësori dhe të dhënat që ai evidenton nga përgjigjet mbetet një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi

cilësinë e punës së secilit.

U konstatua se megjithë vëmendjen e madhe që i kushtohet pyetësorëve, si dhe aspektit që përgjigjedhënsi mbetet anonim, nuk ka ndonjë interes nga studentët për t'u përfshirë në këtë proces. Për studentët e Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, pjesmarrja në përgjigjen e pyetësorëve është në rreth 20%.

Në konkluzion të vleresimit shprehemi se standardet plotësohen.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, që është në shqyrtim, synon që të formojë jo vetëm specialistë të fushës së marrëdhënieve publike, si në sektorin komercial ashtu dhe për institucione, por dhe qytetarë aktivë, të aftë për t'ju përshtatur kërkesave të kohës në tregun e punës, si në sektorin privat ashtu dhe atë publik.

Duke ndjekur standardin e fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit në UET, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese, të këtij programi studimi janë të organizuara në kategori, nga A në F. Disiplinat mësimore të ofruara në kategorinë A, B, E dhe F janë të detyrueshme. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit ku ofrohen 7 lëndë të detyrueshme për të gjithë, në kategorinë C ofrohen 2 lëndë që përcaktojnë diferencimin e profileve, në kategorinë E praktika profesionale. Gjatë semestrit të dytë, studenti krahas programit të praktikës (4 - 10 javë) përgatit dhe punimin e diplomës, mbrojtja e të cilët është kusht i domosdoshëm për diplomim.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Master Profesional Marrëdhënie Publike, në dy profilet, gjatë një viti akademik është një ndërthurje mes njohurive teorike me aplikimin në praktikë të aftësive të fituara. Ky program studimi synon jo vetëm të formojë specialistë të fushës dhe nëpërmjet këtij programi studimi synohet përgatitja e studentëve cilësorë dhe të aftë për tregun e punës.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë
- Semestri i parë ka 14 javë në auditor
- Semestri i dytë ka 14 javë në auditor dhe në praktikë.

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Tabela e Planit mësimor është paraqitur në Aneks, Tabela nr. 7

Bazuar në kurrikulën që zbatohet në Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale mendojmë se janë lëndët e përshtatshme për të arritur synimet dhe objektivat, për t'u dhënë studentëve që ndjekin Programin njohuri teorike dhe shprehi praktike në përgatitjen e tyre si ekspertë të fushës dhe menaxherë të situatave dhe rrethanave që do ju paraqiten në postet e punës. Pesha specifike që iu është dhënë lëndëve përbërës të kurrikulës e vlerësojmë se është proporcionale për të përmbushur misionin që ka ky program, por dhe bazuar në misionin e fakultetit ku përfshihet Programi si atë të UET-it.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Nga raportimi i Vlerësimit të Brendshëm, si dhe nga informacioni që mbledhëm gjatë takimeve në institucion rezultojnë këto ndarje:

- | | |
|------------------------|--|
| ▪ Për leksionet | 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Labororet | 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profes | 255 orë në auditor dhe 45 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 40 orë në auditor dhe 310 orë punë e pavarur e studentit |

Nisur nga profili që ka Programi që kemi në fokus, kohëzgjatja e tij për një vit akademik, si dhe ideimi dhe ndërtimi konkret i kurrikulës, vlerësojmë se kjo ndarje për kohën e leksioneve, seminareve, praktikën profesionale, orët laboratorike e për periudhën e provimit përfundimtar është në funksion të arritjes së objektivave dhe synimeve. Nga biseda që zhvilluam me studentët e dy profileve të Programit që shqyrtohet ata e kanë vlerësuar si efektive këtë proporcion kohor të ngarkesës, sipas tipologjisë së 5 ndarjeve të mësipërme, që po sipas tyre, ju jepte avantazh në asimilimin e pjesës teorike dhe aplikative të programit një vjeçar të studimit dhe finalizimit me provimin përfundimtar.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën 6, Aneksi 6)

Tabela e ndryshimeve në Planin Mësimor është paraqitur në Aneks, , Tabela nr. 8

Ndryshimet rezultojnë më të vogla se 20%

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Tabelat e Planit mësimor lidhur me stafin akademik janë paraqitur në Aneks, (Tabelat nr. 9)

Përgjithësisht pedagogët në lëndët e formimit bazë janë përzgjedhur sipas kritereve të gjithëpranuara. Nga pyetjet në auditor me studentët rezultoi se në përgjithësi ata kishin informacionin e duhur për gruplëndët e formimit bazë.

Nisur nga shqyrtimi i cv-ve të pedagogëve të angazhuar në Program, gradës dhe profilit të tyre kërkimor dhe shkencor, si dhe lëndës që ata kishin, vlerësojmë se ka përputhje, duke vlerësuar se jemi në kushtet e zgjidhjeve të drejta dhe jo të sforcuara (sa për plotësim) të lëndës me një pedagog, i cili mund të kishte gradën, por që do të ishte jashtë profilit dhe fokusit të programit për të cilin është thirrur të përfshihet.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga diskutimi me drejtuesit e departamentit dhe të fakultetit, si dhe shqyrtimi i dokumentave konkrete, evidentuam se syllabuset ishin në përputhje me planet dhe programet e studimit në fokus të këtij vlerësimi, duke përfshirë këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga dokumentacioni i paraqitur nga njësia bazë konstatohet se nga trupa akademike, si pedagogët me kohë të plotë ashtu dhe ata të jashtëm, vlerësohet me seriozitet dorëzimi paraprak të syllabus-eve, sipas një standardi që përfshinte të gjithë aspektet bazë të përmbajtjes, siç dhe është përshkruar më sipër. Përmes këtyre syllabus-eve studentët apo të gjithë të interesuarit identifikonin mënyrën e mësimdhënies nga pedagogu i lëndës, vlerësimin, por dhe hollësi mbi literaturën, detyrimet, listën e temave që do të aplikoheshin. Interesimit tonë gjatë takimit me studentët, se si ata njiheshin me syllabus-et, ata u përgjigjën se për përmbajtjen e tyre informoheshin paraprakisht.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	UET është IAL jopublik, ku programet e studimit për të cilat lëshon diplomë janë të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi. Programet janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e MAS dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Konkretisht për Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale konstatoam se organizimi i tij ishte në module dhe të vlerësuara me kredite sipas ECTS Ngarkesa vjetore me 60 kredite, është e ndarë, proporcionalisht, ku semestrin e parë mbisundon zhvillimi teorik i lëndëve, ndërkohë që në semestrin e dytë studentit ndjek më shumë pjesën praktike të programit. Programet ofrohen

me kohë të plotë.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale përmbush kriteret e vendosura, pasi ofron njohuri të thelluara teorike dhe praktike profesionale, të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e punës.

Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, duke bërë një përsëritje të shpejtë të nocioneve bazë për të akomoduar dhe përfshin njohuri të avancuara për ata studentë që nuk kanë përfunduar studimet Bachelor në këtë fushë.

Nga natyra e programit, si dhe duke pasur parasysh që ai është vetëm në një vit akademik, theks i veçantë është vënë tek praktika profesionale dhe punimi i diplomës. Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Organizimi i Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, lëndët e ofruara prej tij dhe programi i praktikës janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. -Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit. Vlerësimi

	për dy profilet e Programit bëhet me këtë ndarje pikësh: 10 % ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive në seminare; 20 % shlyerja e detyrimeve me detyra detyra kursi; 30 % ka Testi Pjesor, ose provimi i ndërmjetëm dhe 40 % provimi përfundimtar.
--	--

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Programi është hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.

UET-i ka ndërtuar Planin Strategjik 2015-2020, i cili parashton edhe prioritetet për bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar.

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.

Aftësimi profesional i studentëve realizohet jo vetëm përmes praktikës profesionale, e cila kryhet gjatë semestrit të dytë, dhe zgjat thuajse gjithë semestrin, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikativ që ofrohen në programin e studimit.

Aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes zhvillimit të seancave metodologjike për 10 javë rresht, një ditë e javës (në intervalin kohor 15.00 – 16.00 ose 16.00 – 17.00). Një student duhet që të ketë kryer të paktën 60 përqind të kohës së caktuar për zhvillimin e seancave metodologjike.

Programi i studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-it dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.

Duke e orientuar programin që të ketë më shumë shprehje praktike profesionale, që kryet më shumë në 14 javët e dyta të vitit akademik, studenti fiton aftësi për t’ju përgjigjur tregut të punës në fushën e marrëdhënieve publike, si në sektorin publik ashtu dhe atë privat.

Në gjykimin tonë programi, në strukturimin dhe

	<p>aplikimin e kurikulës bashkëkohore është në përputhje me nevojat që kanë sektorë të ekonomisë brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Që gjatë hartimit të programit të studimit departamenti është konsultuar me përfaqësues të rëndësishëm të tregut të punës. Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.</p> <p>Duke qenë se edhe pjesa më e madhe e studentëve që ndjekin studimet në këtë program janë të punësuar, mendimi i tyre ka një rëndësi të madhe në këtë drejtim.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Gjatë hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit. Në qendër është kontributi për formimin demokratik qytetar të studentëve, të aftë për punë, në shërbim të shoqërisë së të ardhmes, ekonomisë së dijes dhe informacionit.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi që kemi në shqyrtim sa i takon periudhës nga viti akademik 2010-2011 deri në vitin akademik 2015-2016, ofrohej me 60 dhe 90 ECTS, e kohëzgjatje 1 vit/1.5 vite (Master Profesional)</p> <p>Aktualisht, nga 2016-2017, programi Master Profesional ofrohet me 60 ECTS, e kohëzgjatje 1 vit. Këto ndryshime janë reflektim i vendimeve të Ministrisë së Arsimit, konkretisht:</p> <p>Akreditimi i parë është bërë me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011, bazuar në Vendimin e këshillit të Akreditimit (VKA) Nr. 133, datë 21.12.2010 (Pozitiv, me rekomandime).</p> <p>Me Urdhër të Ministrit të Arsimit (UMAS) nr. 218, datë 23.05.2011 "Për Regjistrimin e formave të Diplomave "bachelor", "Master Profesional" [...]"</p>

	<p>është bërë regjistrimi i Diplomave. Në këtë dokument emërtimi i diplomës është Master Profesional në Marrëdhënie me Publikun me profile:</p> <ul style="list-style-type: none"> c) Sektori Komercial ose Politik; d) Institucionale <p>Akreditimi i parë i këtij programi (60 kredite) është bërë me UMAS nr 68, datë 14.02.2011 "Për Akreditimin e programeve [...], Programet e studimit master i Nivelit të Parë.</p> <p>Me Urdhër të Ministrit të Arsimit (UMAS) nr. 380, datë 12.10.2015 "Për Regjistrimin e formave të Diplomave "bachelor", "Master Profesional" [...]" është bërë përsëri regjistrimi i Diplomave. Në këtë dokument emërtimi i diplomës është: Master Profesional në Marrëdhënie me Publikun me profile:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Sektori Komercial; b) Politik dhe Institucionale
--	--

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë syllabus-et e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar.</p> <p>Programet e studimit, kurrikula, objektivat formuese dhe mundësitë e punësimit, publikohen në faqen zyrtare. Në mënyrë dinamike të dhëna rreth tyre studentët gjejnë dhe në "depozitën" virtuale përmes komunikimit me LMS. Studentëve u jepet informacion dhe këshillim nga stafi i trajnuar, para regjistrimit, gjatë javës së orientimit dhe këshillimit të karrierës.</p>
---	---

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Dokumenti për punimin e diplomës, pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplomë, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga Departamenti, procesi i shkrimit të tezës, kalendari i seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Përmbushen standardet mbi misionin dhe objektivin e Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, organizimin e vitit

mësimor, semestrat, planet mësimore me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse.

Programi është hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.

Duke e orientuar programin që të ketë më shumë shprehje praktike profesionale, që kryet më shumë në 14 javët e dyta të vitit akademik, studenti fiton aftësi për t'ju përgjigjur tregut të punës në fushën e marrëdhënieve publike, si në sektorin publik ashtu dhe atë privat.

Në konkluzion të vlerësimit, shprehemi se standardet plotësohen.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Programi i studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, organizohet në 6 kategori disiplinash: 1. Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë 2. Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit 3. Kategoria C: Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese 4. Kategoria D: Disiplina të zgjedhura 5. Kategoria E: Veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike, praktika 6. Kategoria F: Përgatitja e tezës së diplomës

Oftohen të ashtuquajturat "Honors course", si pjesë e lëndëve të kategorive C dhe D. Këto propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj të Universitetit. Metodologjia e mësimdhënies dhe mënyra e kontrollit të njohurive i përgjigjet natyrës teorike/praktike të lëndës Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të kategorive A dhe B, ftohen edhe ekspertë, profesorë të shquar të fushës.

Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive të mësimdhënies (A-F) jepet në Tabelën 10

Mënyra e organizimit të lëndës nga pedagogët, si dhe përzgjedhja me kujdes e literaturës, në gjuhë të huaj dhe shqip, përfshirë dhe aplikimin e mjeteve dhe metodave të larmishme didaktike në leksione dhe seminare u vlerësuan nga studentët gjatë bashkëbisedimit apo në intervista të vecanta. Mjaft nga temat e lëndës ata i kombinonin me performanca duke stimuluar situata konkrete nga fusha e marrëdhënieve publike, të cilat ishin atraktive për auditorin duke fiksuar aspekte teorike që ishin trajtuar paraprakisht.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

▪ Leksione	408 orë
▪ Seminare	84 orë
▪ Ushtrime/projekte /detyra	108 orë
▪ Praktikë profesionale	220 orë
▪ Punim Diplome	40 orë
▪ Total	860 orë

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive respektonin modelin e përzgjedhur dhe të afishuar në rregulloren e programit të studimit.

Vlerësimi për dy profilet e Programit bëhet me këtë ndarje pikësh: 10 % ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive në seminare; 20 % shlyerja e detyrimeve me detyra detyra kursi; 30 % ka Testi Pjesor, ose provimi i ndërmjetëm dhe 40 % provimi përfundimtar.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët në ballafaqimin që organizuam me ta dëshmuam se ishin të angazhuar në aktivitetet e njësisë së strukturës didaktike

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për ndjekjen e Programit të studimit Master Profesional, UET-i pranon për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

1. Studenti duhet të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor), ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit e të vlerësuar ekuivalente me të. Kur diploma e fituar nga studimet në ciklin e parë është në të njëjtën fushë studimi, student i regjistruar pa plotësim të njohurive formuese (pa debi formimi). Nëse diploma e ciklit të parë është në një fushë tjetër të ngjashme ose të përafërt, me ngjashmëri të programit në masën jo më pak se 2/3-tat, student i regjistruar me debi formimi deri në 60 ECTS.
2. Studenti duhet të plotësojë kriteret e vendosura nga Këshilli i Fakultetit.
3. Studenti duhet të dorëzojë dokumentacionin e plotë të dosjes së aplikimit që kërkohet nga universiteti.
4. Studenti duhet të posedojë një diplomë të një prej pesë gjuhëve të huaja të kërkuara nga Ministria, që në hyrje të studimeve në programin Master i Shkencave.
5. Studenti duhet të kryejë pagesën e tarifës së regjistrimit, sipas kushteve dhe përcaktimit të kontratës mes tij dhe institucionit.

Aplikimet shqyrtohen nga Departamenti Përgjegjës për programin e studimit, i cili harton listën e kandidatëve të pranuar dhe ia kalon për miratim Dekanit të Fakultetit. Në këtë fazë, Koordinatorja e Departamentit i komunikon secilit kandidat vendimin e pranimit, të mospranimit ose të përfshirjes në listën pritëse. Kandidati që nuk është përzgjedhur mund t'i drejtojë ankesë Dekanit brenda dy ditëve nga dalja e vendimit. Dekani, nëse e sheh të drejtë, propozon ngritjen e një Komisioni Rivlerësimi, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Kandidati që nuk ka fituar mund të aplikojë përsëri vitin e ardhshëm. Lista përfundimtare e studentëve të pranuar shpallet jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Afati normal i studimeve për këtë program studimi është 1 (një) vit akademik. Afati maksimal i përfundimit të studimeve është 2 vjet. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar marrëdhënia mes Universitetit dhe Studentit rinegociohet. Kur student i ka ndërprerë studimet për një periudhë më të gjatë se 3 (tre) vjet, Këshilli i Fakultetit mund të kryejë verifikimin e vjetërsisë së njohurive të tij dhe rivlerëson kreditet e fituara nga student i. Studenti i cili nuk arrin të marrë

asnjë provim brenda 1 një viti akademik, humbet të drejtën e vazhdimet të studimeve. Në programin Master Profesional që është në shqyrtim është si kusht i domosdoshëm dhe kryerja e praktikës profesionale e studentëve që ka një kohëzgjatje 4 plus 10 javë, dmth katër javë në mjediset e UET dhe 10 javë në një institucion a subjekt publik a privat. e cila organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.

UET-i në kuadër të Shoqatës Alumni, vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, në mënyrë periodike mban kontakte të vazhdueshme me ish-studentë të cilët kanë kryer një cikël studimesh pranë UET-it, ku qëllimi i saj është jo vetëm ndarja e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Qëllimi i ALUMNI është të ndihmojë në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim të gjithë studentët dhe të diplomuarit e UET të identifikojnë dhe të përmbushin qëllimet e tyre të karrierës. Nëpërmjet eksperiencës si studentë, UET i ndihmon studentët të kuptojnë kush ata janë dhe do të jenë si profesionistë të ardhshëm si dhe si të aplikojnë njohuritë e tyre akademike dhe aftësitë e punësimit në praktikë. Duke ofruar burime, kontakte, programe të kuptueshme, këshillim karriere, mundësi intershipi dhe punësimi Universiteti European i Tiranës mundëson edukimin e studentëve dhe të sapodiplomuarve se si të marrin vendime për karrierën, të zhvillohen profesionalisht dhe të arrijnë qëllimet e jetës akademike dhe profesionale. Rëndësi të veçantë në identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave të studentëve ka përfshirja e ishstudentëve tanë në aktivitetet e mëposhtme:

Panairin e Punës, duke iu ofruar studentëve aktual një mundësi për të kontaktuar drejtpërdrejt me përfaqësuesit e të paktën 52 kompanive të ndryshme në vend. Nëpërmjet programit 250+ u sigurohet studentëve dhe Shoqatës ALUMNI një sërë mundësish për të mësuar dhe për të ndërvepruar me punëdhënës duke siguruar kontakte me industrinë dhe organizata të ndryshme. Nga takimet që zhvilluam në institucion u informuam se Programi 250+ është vazhdim i iniciativës së UET për t'u shndërruar në një universitet biznesi. Programi ka marrë emrin nga përfshirja e 250 kompanive të mëdha, që janë në partneritet me universitetin, një hapësirë komunikimi me tregun e punës. Boshti kooperues përfshin 4 shtylla kryesore: kualifikim dhe specializime, konsulencë, përgjegjësi sociale, praktikë dhe punësim. Por nga takimi që u zhvillua me studentët e programit Master Profesional Marrëdhënie Publike, në të dy profilet, rezultoi se ata nuk kishin asnjë informacion mbi këtë program.

Në Bordet e punës, si ura lidhëse dhe pika e kontaktit midis praktikës profesionale, tregut të punës dhe internshipeve, anëtarët e shoqatës Alumni ftohen të janë pjesë aktive dhe e pandashme në këtë proces duke reflektuar mbi programet akademike dhe përputhjen e tyre me tregun e punës përmes sugjerimeve praktike duke rritur në këtë mënyrë cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies te studentët tanë ndër vite.

Çmimi i Karrierës, është një traditë në UET. Të gjithë ish studentët që pasi kanë përfunduar studimet kanë arritur një pozicion të mirë pune dhe kanë patur arritje në karrierat e tyre profesionale, vlerësohen me këtë çmim, që synon të promovojë arritjet e ish studentëve dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet në UET.

ALUMNI International, është takimi i përvitshëm i studentëve të UET që studiojnë në universitetet më të mira në botë. Follow up-i i përvitshëm për kontakte per vendet e punes, ngritja e database i kontakteve dhe qëndrimi në kontakt me ta, aktivitete të cilat kanë në fokus rritjen e cilësisë dhe shërbimeve ndaj studentëve dhe universitetit në tërësi. Identifikimin dhe kontaktimi i sa më shumë studentëve Alumni, me qëllim pasqyrimin sa më real të të dhënave të tyre është realizuar duke ndërthurur metoda sasiore të mbledhjes së të dhënave si më poshtë vijon:

- Filtrimi i listave të studentëve të vëna në dispozicion nga zyra e Arkiv-Protokollit dhe Statistikës;

- Identifikimi dhe mbledhja e të dhënave nga plotësimet e formularëve të UET-Alumni-t pas tërheqjes së vërtetimeve të uniformave të diplomimit;
- Kontaktime të drejtpërdrejta me telefonata të personalizuar;
- E-maile studentëve të cilët hezitonin të përgjigjeshin në telefoni, nuk kishin numër kontaktit ose kontakti i tyre ishte jashtë shërbimit;
- Identifikimi i ish-studentëve përmes stafit që punon në UET, duke kontaktuar rrjetin e tyre të kontakteve, etj.

Të gjithë të kontaktuarit janë informuar mbi qëllimin e administrimit e mbledhjes së të dhënave mbi statusin e punësimit dhe mundësitë e mbështetjes nga universiteti. Është tentuar të mblidhen informacione sa më të detajuara lidhur me statusin e punësimit të ish-studentëve, pozicionin si dhe institucionin në të cilin ata angazhoheshin.

Gjatë kontrollit të regjistrave u gjetën studentë pa numra matrikullimi:

- Në listën e studentëve të regjistruar në vitin 2015-2016	10 studentë
- Në listën e studentëve të regjistruar në vitin 2016-2017	4 studentë
- Në listën e studentëve të regjistruar në vitin 2017-2018	të gjithë studentët

Pas verifikimit rezultojn këto arsye:

1. Mospajisja me kartonin e diplomës në Bachelor (vonesa në lëshim, debite financiare)
2. Ekzistenca e emrit në dy programe studimi njëkohësisht (në universitete të ndryshme)
3. Vonesa të AKP (për vitin aktual)

Në sekretarinë mësimore u informuam se problematikat marrin zgjidhje rast pas rasti.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve në këtë Program, bazuar në dokumentacionin që shqyrtoam, apo sipas prezantimeve që na bënë në Departament dhe në Sekretarinë mësimore, ishin në përputhje me standardet e miratuara nga MAS dhe sipas akteve rregullative të UET. (siç janë përshkruar dhe në informacion e mësipërm).

Mënyra e vlerësimit të studentëve paraqitet me pikë, notë e germë (Tabela nr. 12).

Ndarja e formave të kontrollit të njohurive jepet në Tabelën nr. 13

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Për pranimin e studentëve respektoheshin rigorozisht kërkesat në dokumentacion dhe numër, por në këto kërkesa nuk përfshihej ndonjë kriter mesatareje për regjistrim. Në departament argumentonin se numri i reduktuar i koutave ishte në vetvete tregues për cilësinë e pranimeve, por jo që të kishte ndonjë kufi (stekë) për nivel të domosdoshmëm që kandidati të mund të pranohej.

- Studentë të regjistruar në programin e studimit.

Tabela është hartuar mbështetur në të dhënat e RVB (Tabela 14).

Sipas Viteve	Programi Master Profesional "Marrëdhënie Publike" me profile:	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)		Studente te transferuar per Brezat (b)		Totali: (a)+(b)
		MP 60 kredite	MP 60 kredite	Viti I	Viti II	
2011-2012	Spektori Komercial;	5	6			25
	Politik dhe institucionale	11	3			
2012-2013	Spektori Komercial;	1	5			17
	Politik dhe institucionale	9	2			
2013-2014	Spektori Komercial;	2				9
	Politik dhe institucionale	7				
2014-2015	Spektori Komercial;	7	1	1		23
	Politik dhe institucionale	11	2	1		
2015-2016	Spektori Komercial;	15			1	44
	Politik dhe institucionale	24			4	
2016-2017	Spektori Komercial;	9				28
	Politik dhe institucionale	19				
2017-2018	Spektori Komercial;	22				38 (*)
	Politik dhe institucionale	16				

Nga verifikimi të dhënat përputheshin me regjistrat e Sekretarisë së Qëndrore

(*) Numri aktual i studentëve (bazuar në shënimet e marra në këtë sekretari, te regjistruar në total janë 51 studentë, por 38 studentë vazhdojnë studimet, ndërsa pjesa tjetër janë c'rrregjistruar/ose transferuar në një program Msc).

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nga të dhënat që kishim në dispozicion, të pasqyruara dhe në pjesën e tabelave në aneks të këtij raporti evidentohet se nota mesatare e pranimit të studentëve për Programin e studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Spektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, në vitin akademik 2016 - 2017 ka qenë 6.93, ku oshilon nga më e ulta 5.1 dhe më e larta 8.95. Krahasuar me vitet e mëparshme (por dhe me këtë që është në proces, duket qartë se mesatarja e pranimit është nën nivelin mesatar të notës, ndërkohë që në dalje kuota është pak më e lartë. Konkretisht për vitin akademik 2016-2017 është 7.62.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Në pjesën më të madhe studentët ishin të punësuar në përputhje me diplomimin e tyre dhe një pjesë të diplomuarish vinin nga ambiente pune që kërkonin një kualifikim të mëtejshëm.

Të dhëna për punësimin e studentëve, Numri total të diplomuarve, Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën), Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën).

Nga vështrimi i tabelave (Tabela 15 ne Aneks) evidentohet fakti se Deptamenti ka pak info për ecurinë e studentëve pas përfundimit të këtij Programi Master Profesional. Sic dhe na u komunikua nga përfaqëueses të stafit, ata kanë vështirësi në marrjen e informacionit. Referuar të dhënave faktike zyrtare numri i të punësuarve rezulton i ulët për rastin e atyre që ju përputhet puna me diplomën e fituar, kurse për rastin e të punësuarve të cilëve nuk jupërputhet vendi i punës me diplomën nuk krijohet as dhe një percetim nga shkaku i mungesës së informacionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët të cilët ndjekin studimet ne Programin e studimit MP “Marrëdhënie Publike” me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale zotërojnë një diplomë bachelor e cila ka 180 kredite ECTS të grumbulluara.</p> <p>Të gjithë ata që regjistrohen në këtë program kanë plotësuar fillimisht kriteret e përcaktuara nga institucioni</p> <p>Nga takimet me drejtues të institucionit, si dhe të fakultetit ku përfshihet ky Program Master Profesional, si dhe bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, u informuam se UET-i ka bërë përmirësime në aspektin e kriterëve të pranimit të studentëve, në favor të rritjes së cilësisë së tyre.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>UET-i ka një strukturë stabël për të informuar studentët rreth mundësive të tyre për punësim, jo vetëm pas përfundimit të studimeve, por edhe gjatë procesit, ku ata herë pas here njoftohen për aplikime punësimi, nga ana e insitucionit.</p> <p>Studentët marrin informacion rreth programeve të studimit brenda universitetit si dhe për vlefshmërinë e diplomës së tyre jo vetëm brenda Shqipërisë por edhe jashtë saj.</p> <p>UET-i fokusohet te procesi i këshillimit të karrierës për studentët, duke realizuar aktivitete për këtë gjë ose çdo student i interesuar mund të shkojë tek Zyra e</p>

	<p>Këshillimit të Karrierës për t'u informuar për aspekte që ka interes.</p> <p>Gjatë takimit me studentët e Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale ata evidentuan faktin e informimit që në kontaktet e para me institucionin, si dhe në vijim të studimeve mbi mundësinë e punësimit, si dhe mbi vlefshmërinë e diplomës që fitonin pas studimeve.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikave në UET është përgjegjëse për përpunimin e statistikave në nivel institucioni, duke u koordinuar me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna statistikore për ecurinë akademike të studentëve që nga hyrja e tyre në këtë universitet deri në aktin e diplomimit të tyre.</p> <p>UET-i mban dhënat statistikore mbi numrin e të diplomuarve në programet e studimit që kanë përfunduar, sa studentë janë regjistruar, sa janë diplomuar në kohë dhe sa me vonesë, sa studentë janë larguar dhe i kanë lënë përgjysëm studimet. Dokumentacionin përkatës e monitoruam dhe në sekretarinë qendrore të UET, duke u fokusuar tek praktikat konkrete me regjistrimin e studentëve në dy profilet e Programit Master profesional Marrëdhënie Publike, në dy profilet, duke u ndaluar edhe në procedura nga vitet akademike të mëparshme.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Në institucion ka një bazë të dhënash, e aktualizuar, për të gjithë studentët të cilët janë të punësuar, si dhe për pozicionet që ata kanë në institucionet ku punojnë.</p> <p>Institucioni mban po ashtu rekorde mbi numrin e studentëve të cilët vazhdojnë studimet në universitetet e huaja.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>UET-i informon studentët mbi programet e studimeve në mënyrë të detajuar. Java orientuese, që zhvillohet në fillim të vitit akademik shërben për të qartësuar studentët në lidhje me programin e studimit.</p> <p>Gjatë vitit akademik ata kanë informacion të vazhdueshëm për programin e tyre të studimit.</p> <p>Këtë e konfirmuan dhe studentët e Programit Master Profesional që është në fokus. Ata vlerësuan maksimalisht lehtësitë që kanë nga informimi sistematik duke përdorur sistemin LMS, që u jep akses në kohë reale për t'u informuar mbi dinamikën e zhvillimeve në procesin mësimor dhe gjatë fazës së realizimit praktikës. Përgjegjësi i modulit është i gatshëm për të diskutuar rreth vlerësimit të studentit nëse ky i fundit dëshiron të dijë më shumë.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.</p> <p>Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<p>Standardet për procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e tyre, informimi mbi aspekte të realizimit të Programit Master Profesional Marrëdhënie Publike, komunikimi me ish-studentët e diplomuar dhe orientimin për në tregun e punës plotësohet kryesisht.</p> <p>Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes tutoriatit dhe këshillimit akademik, studenti në mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës dhe Praktikave, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET-it.</p> <p>Programi 250+ është vazhdim i iniciativës së UET për t'u shndërruar në një universitet biznesi. Programi ka marrë emrin nga përfshirja e 250 kompanive të mëdha, që janë në partneritet me</p>	

universitetin, një hapësirë komunikimi me tregun e punës. Boshti kooperues përfshin 4 shtylla kryesore: kualifikim dhe specializime, konsulencë, përgjegjësi sociale, praktikë dhe punësim. Por nga takimi që u zhvillua me studentët e Programit të studimit MP "Marrëdhënie Publike" me profile a) Sektori Komercial; b) Politik dhe institucionale, rezultoi se ata nuk kishin asnjë informacion mbi këtë program.

Për këtë aspekt standardet ploteësohen kryesisht.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun është pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës. Proceset e kërkimit shkencor janë të bashkërenduara nga zv/Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë në nivel universiteti. Stafi akademik i cili jep mësim në programin e MP "Marrëdhënie Publike" është i përfshirë në proceset e kërkimit shkencor, konferencave dhe aktiviteteve të tjera akademike që organizohen në Universitet si edhe pjesë e rëndësishme e debateve publike mediatike që organizohen në media të ndryshme kombëtare. Kjo i ka dhënë Departamentit dhe universitetit më gjerë një profil të spikatur publik.

Universiteti i ka një program afatmesëm të kërkimit shkencor "Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020" e cili hartohet çdo 5 vjet dhe përmban drejtimet kryesore të zhvillimit të kërkimit akademik në UET. Sikurse përshkruan edhe Strategjia "... Në dekadën e tij të dytë, UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësim-dhënie, në një institucion elitare kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET."

Sikurse përshkruan edhe Strategjia, sistemi i kërkimit shkencor dhe trajnimit në UET përfshihen (i) Kërkimi dhe Trajnimit; (ii) Trajnimi dhe Certifikimi; (iii) Research & Development.

Çdo projekt i madh kërkimi shkencor përfshin si kërkuesit senior, post doktorale, kërkuesit që janë në proces doktorature dhe kërkuesit e rinj në fillesat e procesit kërkimor. Në kontratat e stafit akademik me UET janë të përcaktuar dhe ekziston një lidhje midis performancës në ecurinë akademike dhe marrjes së titujve dhe gradave shkencore dhe vlerësimit financiar.

Universiteti ka dy botime të rëndësishme:

1. Revista ECONOMICUS (ISSN:2223-6295). Kjo revistë publikon artikuj të lidhur me studimet ekonomike dhe zhvillimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit
2. Revista POLIS (ISSN:2223-8174). Kjo revistë publikon artikuj kërkimorë që lidhen me shkencat humane dhe shoqërore.

Të dyja revistat kanë në brendësi artikuj me tendencat më të reja në fushën shkencore dhe shërbejnë edhe si materiale të rëndësishme didaktike për studentët e fakulteteve respektive. Revistat duhet të marrin më shumë vizibilitet jashtë UET edhe nëpërmjet fuqizimit të faqes online dedikuar për secilën revistë. Aktualisht në faqen online të UET

http://www.uet.edu.al/images/Revistat_shkencore/economicus/Economicus-14.pdf revista

ECONOMICUS është e nr. 14 summer 2016). Ndërsa Revista POLIS kishte nr. 16 të vitit 2017 botim i muajit shtator.

UET ka të ngritur edhe programin e mobiliteteve të stafit akademik duke i përfshirë ata në programe të ndryshme kërkimore dhe rrjete me universitetet e tjera ndërkombëtare. Cdo projekt i madh kërkimor përfshin krahas kërkuesit senior, post doktorantë, kërkues junior, si edhe doktorantë.

Sipas "Strategjisë së kërkimit shkencor 2017-2020" projektet e mëdha kërkimore të UET janë ndarë në shtatë drejtime të mëdha kërkimore që janë të mbështetura edhe tek interdisipliniteti dhe drejtorhen nga kërkues të niveli senior. Fushat kryesore të rritjes së kërkimit shkencor janë: (i) Politika, komunikimi, shoqëria; (ii) Nga Big Data në Big Business; (iii) Axhenda e re rritjes; (iv) Zhvillimi nëpërmjet edukimit; (v) Ligji midis efciences dhe drejtësisë; (vi) E drejta dhe institucionet publike në transformim; (vii) Risku, Loja e të gjithë aktorëve.

Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH) janë një tjetër iniciativë e ndërmarrë në formatin e konferencës për të prezantuar punimet sa më të mira dhe për tu shndërruar në formatin e konferencës serioze në vend. Për këtë arsye sipas strategjisë janë vendosur disa kritere klasifikuese të tilla që nuk pranohen prezantime vetëm me poster dhe priesantimet janë në anglisht. Synimi është të sillen edhe akademikët shqiptarë që janë në diasporë të cilët do ti shërbejnë dhe do të jenë stimulues për kërkimin shkencor në vend. Në faqen e universitetit ndodhet një nënfaqe e Ditëve të Studimeve Shqiptare

<http://www.uet.edu.al/index.php/sq/kerkimi-shkencor-3/dssh1> dhe aty gjendet informacioni më i updatë për konferencën e 27-28 prill 2018.

Përgjegjsja e Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës ka qënë edhe në panelin e parë "Politics, Communication and Society".

http://www.uet.edu.al/images/pdf/DSSH_CfP_2018.pdf

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor në Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun realizohet si nëpërmjet punës individuale të pedagogëve ashtu edhe me atë të përfshirjes në projekte të fituara dhe zbatuar nga UET. Në disa nga këto projekte janë të përfshirë edhe studentë të ndryshëm në ciklin e parë dhe të dytë në varësi të tematikave.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Nga dokumentacioni i dhënë nga Departamenti gjatë vizitave të GVJ rezulton lista e mëposhtë e botimeve sipas pedagogëve::

- Prof. Dr. Ylljet Alicka ka publikuar 8 studime me tematika të ndryshme në periudhën 2016-2017
- Prof.Asoc. Dr Genciana Abazi-Egro ka realizuar 3 studime dhe pjesëmarrje në konferenca me tematika të ndryshme në periudhën 2016-2017
- Dr. Brikena Smajli ka realizuar 5 studime dhe pjesëmarrje në konferenca me tematika të ndryshme në periudhën 2016-2017
- Dr. Otjela Lubonja ka realizuar 3 studime dhe pjesëmarrje në konferenca me tematika të ndryshme në periudhën 2016-2017
- Lorena Licenji PhD ka realizuar 3 studime dhe pjesëmarrje në konferenca me tematika të ndryshme në periudhën 2014-2017

- Dr. Kled Kapexhiu ka realizuar 3 dalje në emisione televizive me tematika të lidhuara me teatrin dhe aktorët në periudhën 2016-2017
- Dr. Irena Myzeqari ka realizuar 6 studime dhe pjesëmarrje në konferenca me tematika të ndryshme.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Nuk ka projekte specifikisht të fituara nga Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, por ato janë pjesë e projekteve që janë fituar nga Qendra e Projekteve për të gjithë universitetin.

Numri i projekteve të zbatuara

Zbatimi i projekteve nga Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, është pjesë e tërësisë së zbatimit të projekteve të mëdha që ka bërë UET. Departamenti ka punuar në konferencat vjetore sic janë p.sh. "Ditët e Studimeve Shqiptare" por ato janë pjesë e projekteve që janë fituar nga Qendra e Projekteve për të gjithë universitetin.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun është pjesëmarrës në organizimin e "Ditët e Studimeve Shqiptare"

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Nuk është i përcaktuar vetëm për Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun. Ai varion nga konferenca kombëtare me pjesëmarrje shumë të gjerë deri në aktivitete me të ftuar me pjesëmarrjen vetëm të departamentit dhe studnetëve të programeve.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Nuk ka të dhëna të përcaktuara që të jenë të lidhura specifikisht vetëm me këtë program MP "Marrëdhënie Publike"

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Gjatë vitit akademik 2015-2016 - Një pedagoge dhe një studente e MP
 Gjatë vitit akademik 2016-2017 - Tre pedagoge dhe tre studentë të MP
 Gjatë vitit akademik 2017-2018 - Tre pedagoge dhe tre studentë të MP

Numri i Çmimeve Kombëtare

Nuk ka informacione për këto çmime kombëtare të lidhuar me studentët e MP "Marrëdhënie Publike"

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si pjesë e strukturës organizative të Universitetit Evropian të Tiranës ka mundësinë e publikimit në revistën POLIS botim i UET. Pedagoqe të këtij departamenti janë autorë të shkrimeve dhe përkthimeve të bëra në këtë revistë ndër vite. Në funksion të marrjes së titujve dhe gradave shkencore, pedagoget e Departamentit publikojnë edhe në revista të tjera ndërkombëtare</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun ka një profil të shquar publik dhe mediatik me prezencë në debate televizive. Personeli është pjesëmarrës edhe në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UET nxit kualifikimin e stafit dhe pjesëmarrjen në kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Një nga mundësitë janë Ditët e Zhvillimit të Stafit me synim trajnimin e tij në aspektet profesionale.</p> <p>Në funksion të UET është edhe Qendra e projekteve e ndërtuar disa vite më parë dhe e emërtuar "Instituti Pashko" që i përfshin stafin akademik në programe të ndryshme kërkimi.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun planifikon në fillim të vitit aktivitetin kërkimor të pedagoqeve anëtarë të stafi, si edhe publikimeve që ata planifikojnë të bëjnë.</p> <p>Çdo pedagog, lidhur edhe me sistemin e gradave shkencore paraqet në departament axhendën e tij kërkimore dhe informacionin për punimet e tij.</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET ka një bazë të dhënash të projekteve në të cilat merr pjesë stafi akademik dhe gjithë</p>

marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	databazën e projektit.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Për arsye të natyrës specifike të fushës së studimit, Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënies me Publikun ka një komponentë të spikatur të pjesëmarrjes në debatet publike mediatike. Pedagoget e tij janë të angazhuar në programe kërkimore dhe aktivitete kombëtare duke i plotësuar standardet. Pedagoget kenë mundësinë e botimit në revistën POLIS por edhe në revista të tjera jashtë UET.</p> <p>Pranë UET është e ngritur Zyra e projekteve e cila koordinon procesin e shkrimit të projekteve, aplikimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve të fituara duke i dhënë gjithë stafit të UET mundësinë e përfshirjes në programe të kërkimit shkencor.</p> <p>Në gjykimin e GVJ standarti për këtë pikë plotësohet.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UET që në krijimin e tij e ka pasur mjaft të theksuar komponentin e lidhjes dhe bashkëpunimit me organizata të tjera të shoqërisë civile me institucione të tjera në nivel kombëtar. Me kalimin e viteve është forcuar edhe bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar me universitete të tjera si edhe përfshirja në rrjete universitetesh në Europë e më gjerë. Me krijimin e Qendrës UET në fillimet e vitit 2010, forcimin e saj të mëtejshëm dhe ndryshimin e saj, në qendër për aplikimin dhe zbatimin e projekteve është forcuar edhe më tej bashkëpunimi i jashtëm. Nëpërmjet qendrave kërkimore UET bashkëpunon me projekte ndërkombëtare si TEMPUS, JEAN MONNET dhe ERASMUS +. Po kështu UET bashkëpunon edhe me organizata të shoqërisë civile në vend si Fondacioni Shoqëri e Hapur për Shqipërisë SOROS Albania, Fondin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Kooperim, etj.

Zyra e projekteve e UET ka iniciuar krijimin e rrjetit "Next Europe" me universitete të ndryshme në vendet e Ballkanit Perëndimor (Serbi, Bosnje-Hercegovinë, Mal i Zi dhe Maqedoni) dhe me universitete e qendra kërkimore të tjera në Evropë.

UET është pjesë e rrjetit ndërkombëtar të universiteteve SEUN për sipërmarrjen rinore dhe inovacionin si një rrjet i cili mbështetet nga Komisioni Evropian për të mbështetur prespektivën enterprenership me përfaqësues nga 20 vende anëtare të EU. Ky netëork ka në fokus krijimin e faktorëve të inovacionit, transferimin e dijeve, aksesin e talenteve.

Të tjera bashkëpunime të UET janë edhe:

- Universitetin e Aston në Britaninë e Madhe për shkollën Doktorale;
- La Spapiencia në Romë
- CEU në Budapest

Mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik realizohet nëpërmjet projekteve si ERASMUS+ KA1 dhe KA2, COST dhe Horizon 2020. Këto janë projekte ndrkombëtare multilaterale. UET ka edhe projekte bilaterale me vende si Austria, Turqia etj.

Lidhja me tregun e punës realizohet nëpërmjet programit 250+ i shpjeguar edhe tek pika 9 per studnetët dhe mundësinë që u jepet atyre për tu lidhur me 250 kompanitë më të mëdha të biznesit dhe institucioneve në vend. Kjo është në vazhdimësi të Bordeve të Tregut të Punës të cilat funksionojnë pranë cdo departamenti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar sipas të dhënave nga UET është si më poshtë
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare - është 13 pjesëmarrës
 - Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj - është 37 leksione
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit - është 30 ku përfshihet stafi akademik dhe me programet ERASMUS
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL – 13 studnetë kanë ardhur ne UET përmes bursave ERASMUS+; 38 studentë nga UET kanë përfituar bursa ERASMUS+; 19 studentë kanë lëvizur përmes programeve si SIGMA dhe shkëmbimeve bilaterale
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor – Biblioteka ka abonime online në EBSCO, SAGE online; Laboratori i TI ka infrastrukturë për kundër plagjarizmit. UET ka disa salla konferencash dixhitale
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime – janë 21 pjesëmarrje (ERASMUS+ staf administrativ)
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Sipas deklarimeve nga UET bashkëpunimi është si më poshtë:

A. Institucionet qeveritare bashkëpunuese dhe universitete:

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës;
2. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan
3. Universiteti “Fan. S. Noli” Korçë
4. Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”
5. Universiteti Bujqësor Tiranë
6. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
7. Universiteti “Marin Barleti”
8. Universiteti Polis
9. Kolegji Universitar Luarasi
10. Universiteti Ismail Qemali Vlorë
11. Universiteti Pavarësia
12. Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër
13. Universiteti Epoka
14. Universiteti i New York në Tiranë
15. Instituti Kanadez i Teknologjisë

16. Këshilli Britanik
17. Ambasada e Britanisë në Tiranë
18. Komisioni Evropian
19. Mediterranean Citizen's Assembly
20. GIZ – Zyra në Tiranë
21. GFK – Growth for Knowledge e Austrisë
22. NUFFIC – ambasada Hollandeze në Tiranë
23. UNICEF - Tiranë
24. UNDP - Tiranë
25. Ambasada e SHBA Tiranë
26. Fondacioni SOROS - Tiranë
27. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile - Tiranë
28. Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit Tiranë
29. Fondacioni ABC Tiranë
30. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim Tiranë
31. World Vision Tiranë

Ndërkohë që UET ka të lidhura marrëveshje dhe projekte me mjaft universitete në kuadër të programeve ndërkombëtare si më poshtë:

1. **Austria** – bashkëpunim me Universitetin e Salzburgut, Buku University of natural Resources and Life Science, Danube University Krems, Universiteti i Graz Karl Franzens
2. **Belgjika** – Universite Libre de Bruxelles
3. **Bosnje – Hercegovina** - bashkëpunim me Universitetin e Bihac, Universitetin Burch, University Dzel Mostar, University of Mostar, University of East Sarajevo, Universiteti i Zenica, Universiteti Ndërkombëtar i Sarajevës.
4. **Kroacia** - bashkëpunim me Universitetin e Splitit
5. **Qipro** - bashkëpunim me Universitetin e Qipros
6. **Republika Çeke** - bashkëpunim me College of Managerial Informatics and Economics, Birno University of Technology, Masaryk University
7. **Finlanda** - Lappeenranta Universitet of Teknology dhe Savonia University of Applied Science.
8. **Franca** – bashkëpunim me Univesite du Maine - le Mains, Institute Agronomique Mediterren de Montpellier
9. **Gjeorgjia** – bashkëpunim me Tbilisi State University
10. **Gjermania** – bashkëpunim me Universitetin e Duseldorf Heinrich–Heine; Humboldt University, Kolblenz-landau University; Leuphana University Luneburg; Ludwingshafen University, University of Duisburg Essen, Emden –Leer University
11. **Britania e Madhe** – bashkëpunim me BPP University London, Ason University; University of Northhampton; Richmond, the American International University, University of South Wales
12. **Hungaria** - bashkëpunim me CEU, Eotvoslorand University, Linum Faoundation, Obuda University Budapest




13. **Irlanda**- bashkëpunim me University of Limerick
14. **Izraeli** bashkëpunim me Bar -llan University
15. **Italia** - bashkëpunim me Universitein "Jean Monnet University of Casamassima, Ca Foscari University of Venice, European University of Roma, University Pavia, University Bari, University Bologna, University Camerino, University of Marconi, University of Palermo, University of Parma, University of Salerno, University of Teramo, University of Trieste, University Roma 3
16. **Kosova** - bashkëpunim me "fama" University College, Kadri Zeka University of Gjilan, Universum University College, AAB Riinvest University, Iliria University, University of Business and Technology UBT
17. **Kuvajti** - bashkëpunim me State University of Kuvajt
18. **Latvia** - bashkëpunim me Liepajs University
19. **Lituania**- bashkëpunim me Vilnius University, Klaipeda University, Siauliai, Vilnius University of Applied Science
20. **Maqedonia** - bashkëpunim me South East European University, State University of Tetova, SsCyril and Methodius University in Skopje.
21. **Mali i Zi** - bashkëpunim me University of Montenegro,
22. **Hollanda** - bashkëpunim me Twente, The Hague, University of Applied Sciences
